



Demokracia në Veprim
Demokratija na Delu
Democracy in Action

RAPORTI I VËZHGIMIT TË ZGJEDHJEVE PËR KUVENDIN E KOSOVËS

DEMOKRACIA NË VEPRIM



9 SHKURT, 2025

RAPORTI I VËZHGIMIT TË ZGJEDHJEVE PËR KUVENDIN E KOSOVËS

DEMOKRACIA NË VEPRIM

9 SHKURT, 2025

Copyright ©2025. Demokracia në Veprim (DnV).

Opinionet, të gjeturat dhe rekomandimet e shprehura në këtë raport janë përgjegjësi e Demokracisë në Veprim dhe jo domosdoshmërisht paraqesin pikëpamjet e donatorit.

Adresa: Rr. Bajram Kelmendi, Nr.239.
10,000, Prishtinë, Kosovë.
Tel: +383 (0) 38 248 038
E-mail: info@kdi-kosova.org
Ueb: www.demokracianeveprim.org

Demokracia në Veprim

Dizajn: ENVINION

Përmbajtja

LISTA E AKRONIMEVE	6
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	8
1. MISIONI DHE METODOLOGJIA E DNV-SË	10
2. KONTEKSTI POLITIK	11
3. KORNIZA LIGJORE	12
4. ADMINISTRIMI I ZGJEDHJEVE	14
4.1 PUNA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE	14
4.2 KOMISIONET KOMUNALE ZGJEDHORE DHE KËSHILLAT E VENDVOTIMEVE	16
4.3 PUNA NË QENDRAT KOMUNALE TË NUMËRIMIT	17
4.4 PUNA NË QENDRËN E NUMËRIMIT DHE REZULTATEVE	18
4.5 CERTIFIKIMI I SUBJEKTEVE POLITIKE DHE KANDIDATËVE TË TYRE	19
4.6 CERTIFIKIMI I LISTËS SË VOTUESVE DHE SHËRBIMI I VOTUESVE	21
4.7 VOTIMI JASHTË VENDIT	26
5. FUSHATA ZGJEDHORE	29
6. PËRFSHIRJA E GRAVE NË PROCES ZGJEDHOR	33
7. VËZHGIMI I ZGJEDHJEVE	39
8. DITA E ZGJEDHJEVE	41
9. REZULTATET ZGJEDHORE	44
10. DREJTËSIA ZGJEDHORE	46
REKOMANDIMET	49
I. REFORMA E SISTEMIT ZGJEDHOR	49
II. KORNIZA LIGJORE	49
III. ADMINISTRIMI I PROCESIT ZGJEDHOR	50
Për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve:	50
Për trupat tjera menaxhuese të zgjedhjeve (KKZ, KVV, QKN dhe QNR):	51
Lista e Votuesve:	52
Votimi jashtë vendit:	52
IV. FUSHATA ZGJEDHORE	53
Financimi i subjekteve politike gjatë fushatës	53
V. PËRFAQËSIMI GJINOR	54
VI. DREJTËSIA ZGJEDHORE	54
SHTOJCA 1: REZULTATET E CERTIFIKUARA TE ZGJEDHJEVE DHE	
NDARJA E ULËSEVE SIPAS SUBJEKTEVE POLITIKE	55

Lista e akronimeve

AAK	Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës
AIP	Agjencia për Informim dhe Privatësi
ARC	Agjencia për Regjistrim Civil
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
DGJC	Departamenti i Gjendjes Civile
DnV	Demokracia në Veprim
DP	Departamenti i Pensioneve
DPD	Departamenti për Prodhimin e Dokumenteve
GI-SPO	Građanska Inicijativa Za Slobodu Pravdu i Opstanak
GjS	Gjykata Supreme
IRDK	Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës
JGP	Jedinstvena Goranska Partija
KDTP	Kosova Demokratik Türk Partisi
KDI	Instituti Demokratik i Kosovës
KGJK	Këshilli Gjyqësor i Kosovës
KKZ	Komisioni Komunal Zgjedhor
KVV	Këshilli i Vendvotimit
KQZ	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
LDK	Lidhja Demokratike e Kosovës
LTO	Vëzhguesit afatgjatë
LVV	Lëvizja Vetëvendosje

MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
MPJD	Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës
NDS	Nova Demokratska Stranka
NISMA	Nisma Socialdemokrate
OSBE	Misioni i OSBE-së në Kosovë
PAI	Partia e Ashkalinjëve për Integrim
PDAK-LpB	Koalicioni Partia Demokratike të Ashkalinjve të Kosovës dhe Lëvizja për Bashkëveprim
PDK	Partia Demokratike e Kosovës
PLE	Partia Liberale Egjiptiane
PREBK	Partia Rome e Bashkuar e Kosovës
PVT	Parallel Vote Tabulation
PZAP	Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
QKN	Qendra Komunale e Numërimit
QNR	Qendra e Numërimit dhe Rezultateve
SDU	Socialdemokratska Unija
SKQZ	Sekretariati i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve
SL	Lista Serbe
STO	Vëzhguesit afatshkurtër
VAKAT	Koalicioni VAKAT
ZRCKFSP	Zyra për Regjistrimin, Certifikimin dhe Kontrollin Financiar të Subjekteve Politike

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Koalicioni i organizatave vendore për vëzhgimin e zgjedhjeve, Demokracia në Veprim (DnV), vlerëson se zgjedhjet parlamentare të 9 shkurtit u zhvilluan në përputhje me standardet demokratike për zgjedhje të lira, konkurruese dhe të drejta. Administrimi i operacioneve zgjedhore ishte përgjithësisht i rregullt, përjashtuar procesin e publikimit të rezultateve dhe numërimit të votave për kandidatët, i cili u karakterizua me vonesa dhe probleme të theksuara teknike e organizative

Procesi i votimit dhe numërimit gjatë ditës së zgjedhjeve është zhvilluar përgjithësisht në një atmosferë të qetë dhe demokratike, i karakterizuar nga një interesim relativisht i lartë i votuesve për të marrë pjesë në zgjedhje. Megjithatë, procesi i votimit është shoqëruar me disa parregullsi dhe shkelje, kryesisht të natyrës procedurale. Nuk është raportuar për incidente serioze gjatë votimit që do të mund të cenonin integritetin e zgjedhjeve.

Problemet teknike me sistemin elektronik të publikimit të rezultateve të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), të shfaqura vetëm disa orë pas përfundimit të votimit, krijuan konfuzion të madh dhe ulën besimin e publikut në transparencën e procesit. Kjo situatë çoi në përdorimin e metodave manuale të përpunimit dhe krahasimit të rezultateve, duke qenë se paraprakisht u raportuan rezultate matematikisht të pamundura, të dhëna të pasakta për daljen në votime, dhe probleme të tjera me formularët e rezultateve.

Është për t'u përhëndetur qasja vetpërmbytëse e subjekteve politike kryesore që, pas përfundimit të votimit, përkundër problemeve me sistemin elektronik të publikimit të rezultateve, i kanë njohur dhe pranuar në mënyrë të qetë rezultatet preliminare të zgjedhjeve për subjektet politike.

Numërimi i votave për kandidatët në Qendrat Komunale të Numërimit ka filluar me vonesa të konsiderueshme për shkak të mungesës së pajisjeve dhe softuerëve të nevojshëm, mbikëqyrjes së dobët teknike dhe mungesës

së koordinimit të stafit në terren. Në disa raste, numërimi nuk nisi deri më 16 shkurt, ndonëse ligjërisht duhej të fillonte më 10 shkurt. Pavarësisht kësaj, pas tejkalimit të konfuzionit fillestar procedural, procesi i numërimit u vlerësua si transparent dhe përgjithësisht i rregullt. Vëzhguesit raportuan raste të rishqyrtimit të fletëvotimeve të pavlefshme nga vendvotimet që më pas u shpallën të vlefshme, duke reflektuar mangësi në trajnimin dhe kuptimin e kriterëve për vlefshmërinë e votës nga ana e komisionerëve të vendvotimeve.

Fushata zgjedhore për këto zgjedhje ishte e para me një kohëzgjatje të plotë prej 30 ditësh, duke sjellë një ritëm të lartë të aktiviteteve zgjedhore dhe një angazhim të shtuar të subjekteve politike në terren dhe në hapësirën digjitale – në të cilën, për këtë fushatë 30-ditore, është shënuar shifër rekord e shpenzimeve prej mbi 200 mijë eurosh nga subjektet politike dhe kandidatët e tyre.

Mungesa e rregullimit ligjor për aktivitetet e parafushatës zgjedhore krijoi një hapësirë të pakufizuar për angazhim paraelektoral të partive politike në Kosovë, duke krijuar edhe mundësinë për shmangie të raportimeve financiare dhe sanksioneve gjatë kësaj periudhe.

Fushata zgjedhore ishte dinamike, atraktive dhe programore. Ndërsa diskursi politik gjatë fushatës ishte i ashpër, veçanërisht nga partia në pushtet, çka rezultoi në një numër rekord të gjobave të shqiptuara nga Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), me një vlerë të përgjithshme mbi 600 mijë euro.

Votimi jashtë vendit ishte operacioni më i prekur nga ndryshimet e fundit ligjore, duke i zgjeruar mundësitë e votimit për qytetarët në diasporë edhe fizikisht në misionet diplomatike, por edhe me postë në fahet postare jashtë vendit. Interesimi i qytetarëve jashtë vendit për të votuar ishte i lartë, me mbi 100 mijë votues të regjistruar për të votuar. Numri i përgjithshëm i zarfeve me fletëvotime të pranuar nga kutitë postare jashtë Kosovës dhe të konfirmuara nga shërbimi postar ishte 68,715 sosh.

Ndërsa, në mesin e 20,324 votuesve me të drejtë vote fizikisht në misione diplomatike (gjithsej 43 vendvotime), 15,348 prej tyre ushtruan të drejtën e votës.

Votimi jashtë vendit u karakterizua me ndërhyrje politike të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës (MPJD), në pothuajse të gjitha fazat e tij. Dështimet dhe problemet me transportimin e votave kanë ngritur dyshime lidhur me sigurinë dhe integritetin e këtij procesi.

Për më tepër, janë evidentuar dallime të konsiderueshme në rezultatet e votimit me postë, ku përkundër që Lëvizja Vetëvendosje (LVV) dominoi në votimin fizik nëpër misione diplomatike, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) performoi jashtëzakonisht pozitivisht në votimin me postë – përfshirë përqindje shumë të larta për disa kandidatë specifike. Pavarësisht refuzimit të ankesave të LVV nga PZAP dhe Gjykata Supreme, këto gjetje ngritën dyshime për mundësi manipulimi ose modele të pazakonshme votimi, ndërsa procesi i hetimit penal mbi këtë çështje është autorizuar nga Prokuroria Themelore në Prishtinë dhe është në zhvillim e sipër.

Procesi vendimmarrës i trupave menaxhuese zgjedhore ishte përgjithësisht konsensual, ndonëse për disa çështje të ndjeshme pati përplasje mes anëtarëve, sidomos ndërmjet përfaqësuesve të partisë në pushtet dhe të tjerëve. Në disa raste, vendimmarrja e KQZ-së u shoqërua me interpretime të gjera të kompetencave ligjore dhe tendenca për të vepruar përtej mandatit të saj, duke kompromentuar pavarësinë institucionale dhe perceptimin për paanshmëri.

Edhe pse këto zgjedhje ishin të rregullta sa i përket kalendarit kohor, duke i dhënë KQZ-së më shumë kohë për planifikim dhe ekzekutim, janë shënuar vonesa në disa procese kyçe, përfshirë miratimin e përbërjes së komisioneve komunale zgjedhore, krijimin e qendrave komunale të numërimit dhe publikimin e qendrave të votimit jashtë vendit.

Një nga sfidat teknike kryesore të këtyre zgjedhjeve ishte çështja e ngjyrës matrikuluese. Procesi i tenderimit për këtë material u shoqërua me vonesa dhe probleme cilësore, të cilat rezultuan me raportime për fshirje të le-

htë të saj nga gishtat e votuesve. Për më tepër, vetë përdorimi i matrikulimit si metodë për shënimin e votuesve u kritikua nga organizatat e shoqërisë civile dhe Agjencia për Informim dhe Privatësi (AIP), të cilat e konsideruan atë si shkelje të fshehtësisë së votës.

Në kuadër të organizimit të zgjedhjeve, KQZ mori disa vendime që u kritikuan për cenimin e fshehtësisë së votës. Një prej tyre ishte vendosja e kabinave të votimit në pozita ballore, e cila u konsiderua problematike pasi rrezikonte ekspozimin e preferencave të votuesve. Ky vendim u ndryshua pas presionit nga shoqëria civile. Për të rritur transparencën dhe parandalimin e manipulimeve, KQZ vendosi të shfrytëzojë kamera në vendvotime për regjistrimin e procesit zgjedhor.

Gjatë fushatës zgjedhore, peizazhi mediatik ishte i polarizuar, duke u karakterizuar nga dy zhvillime kryesore: partia në pushtet mbajti një qasje vazhdimisht konfrontuese ndaj gazetarëve, ndërsa disa media u perceptuan si të njëanshme në mbulimin dhe raportimet e tyre.

Në këto zgjedhje, aplikuan për certifikim 28 subjekte politike me gjithsej 1,280 kandidatë. Në përgjithësi, KQZ miratoi aplikacionet e të gjitha subjekteve, me përjashtim të Listës Serbe, vendimi për të cilën shkaktoi debat të gjerë dhe ngriti shqetësime mbi qasjen e barabartë në garën zgjedhore. Në këtë rast, kundërligjshëm u refuzua certifikimi i saj, pavarësisht rekomandimit të Zyrës për Regjistrimin, Certifikimin dhe Kontrollin Financiar të Subjekteve Politike (ZRCKFSP). Më vonë, Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa dhe Gjykata Supreme vendosën për certifikimin e këtij subjekti, duke e korrigjuar vendimin fillestar të KQZ-së, duke shfaqur dominimin e konsideratave politike mbi parimet ligjore në disa aspekte të administrimit të zgjedhjeve.

Zgjedhjet parlamentare të 9 shkurtit 2025 u monitoruan nga një numër i konsiderueshëm vëzhguesish, duke përfshirë përfaqësues të partive politike, organizatave të shoqërisë civile, misioneve ndërkombëtare dhe mediave. Në total, mbi 20,000 vëzhgues u akredituan për të mbikëqyrur mbarëvajtjen e procesit zgjedhor në të gjitha nivelet.

1. MISIONI DHE METODOLOGJIA E DNV-SË

Demokracia në Veprim është koalicion i organizatave jo-qeveritare në Kosovë që promovon zgjedhje të lira dhe të drejta përmes monitorimit sistematik të proceseve zgjedhor, edukimit të votuesve dhe avokimit aktiv për reforma zgjedhore. Për zgjedhjet parlamentare të 9 shkurtit 2025, DnV ka angazhuar rreth 700 vullnetarë për të siguruar një monitorim gjithëpërfshirës dhe objektiv.

Ky raport përmban vlerësimin e detajuar të procesit zgjedhor, duke filluar nga periudha përgatitore pas shpalljes së datës së zgjedhjeve nga Presidentja e vendit, aktivitetet e institucioneve përgjegjëse për administrimin e zgjedhjeve, procesin e votimit, numërimin e votave – duke përfshirë punën në Qendrat Komunale të Numërimit dhe Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve – shqyrtimin e kontesteve zgjedhore dhe shpalljen e rezultateve përfundimtare.

Për periudhën e fushatës zgjedhore, DnV ka përgatitur raporte të veçanta të monitorimit,¹ që trajtojnë mbarëvajtjen e përgjithshme të fushatës, gjuhën politike në rrjetet sociale, si dhe monitorimin që u është bërë mediave gjatë periudhës së fushatës. Monitorimi i kësaj periudhe është realizuar nga 44 vëzhgues afatgjatë (LTO), të cilët kanë përcjellë aktivitetet publike në gjithë territorin, përfshirë edhe zonat me shumicë serbe. Po ashtu, janë monitoruar nga afër mbledhjet e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe Komisioneve Komunale Zgjedhore.

Në ditën e zgjedhjeve, mbi 600 vullnetarë u angazhuan në terren, prej të cilëve 500 sipas metodologjisë Parallel Vote Tabulation (PVT), një metodologji e njohur ndërkombëtarisht, bazuar në një mostër të provuar statistikore. Njëkohësisht, rreth 50 vëzhgues të tjerë, si ekipe mobile, kanë vëzhguar atmosferën e përgjithshme në

Qendrat e Votimit dhe përreth tyre, ndërsa 50 vullnetarë të tjerë janë angazhuar në Qendrën e Thirrjeve, duke mbledhur, procesuar dhe analizuar në kohë reale të dhënat nga terreni.

Vëzhguesit afatshkurtër (STO) janë trajnuar paraprakisht nga ekipe të specializuara lidhur me metodologjinë e monitorimit, procedurat zgjedhore dhe raportimin online të të dhënave. Raportimet nga terreni janë procesuar menjëherë në databazën elektronike të krijuar enkas për këtë qëllim, duke rezultuar në publikimin e komunikatave dhe njoftimeve për media gjatë gjithë ditës së zgjedhjeve.

Në mënyrë komplementare, ekipet mobile të DnV-së monitoruan procesin e numërimit në disa prej Qendrave Komunale të Numërimit dhe në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve. Gjithashtu, ekipi ligjor i DnV-së përcolli në vazhdimësi shqyrtimin e kontesteve zgjedhore në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa, si dhe në Gjykatën Supreme.

Metodologjia e aplikuar në këtë monitorim respekton plotësisht standardet ndërkombëtare për zgjedhje demokratike.

¹ Metodologjia e këtyre raporteve do të elaborohet ndaras në secilin prej raporteve.

2. KONTEKSTI POLITIK

Që nga shpallja e pavarësisë në vitin 2008, Kosova ka kaluar një periudhë të vazhdueshme të paqëndrueshmërisë politike. Të gjitha zgjedhjet parlamentare që u mbajtën në periudhën 2008–2021 ishin zgjedhje të parakohshme, duke reflektuar një kulturë politike të shoqëruar nga kriza të shpeshta politike, pamundësi për të siguruar stabilitet institucional, si dhe ndërhyrje të herëpashershme të Gjykatës Kushtetuese për interpretimin e proceseve të formimit dhe rrëzimit të qeverive.

Zgjedhjet e 9 shkurtit 2025, të gjashtat që nga viti 2008, përfaqësuan një pikë kthesë, duke qenë hera e parë që procesi zgjedhor u zhvillua në përputhje të plotë me afatet e rregullta ligjore. Qeveria e drejtuar nga Lëvizja Vetëvendosje, me Kryeministër Albin Kurtin, ndonëse fitoi mbi 50% të votave në zgjedhjet e vitit 2021, u ballafaqua vazhdimisht me sfida serioze në sigurimin e shumicës parlamentare për vendimmarrje, duke e bërë të vështirë zbatimin e agjendës së saj qeverisëse, si në planin e brendshëm ashtu edhe atë të jashtëm.

Kjo periudhë u karakterizua edhe nga fragmentimi i brendshëm politik, ku çështje sensitive, si reforma në sistemin e drejtësisë dhe miratimi i Kodit Civil, nxitën debate dhe kundërshtime brenda grupit parlamentar të LVV-së, duke shkaktuar edhe largimin e disa deputetëve. Kjo situatë e dobësoi pozicionin parlamentar të Qeverisë dhe e detyroi atë të bëhej gjithnjë e më e varur nga votat e deputetëve nga komunitetet jo-shumicë për kalimin e ligjeve dhe vendimeve të rëndësishme. Në këtë kontekst, opozita parlamentare, e përbërë nga PDK, LDK dhe AAK, ruajti qëndrim të unifikuar kundër qeverisë, duke refuzuar në mënyrë sistematike bashkëpunimin me shumicën qeverisëse. Sfidimi i iniciativave të partisë në pushtet, disa prej të cilave përfunduan edhe në Gjykatë Kushtetuese, si dhe abstenimi nga pjesëmarrja në votime, kontriboi në një klimë polarizuese gjatë gjithë mandatit.

Në aspektin e politikës së jashtme, procesi i dialogut me Serbinë vazhdoi nën ndërmjetësimin e Bashkimit Evropian dhe rezultoi me nënshkrimin e Marrëveshjes së Ohrit në mars 2023. Megjithatë, obligimet e marra, sidomos ajo e themelimit të Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe, u shndërruan në pika të mëdha të përplasjes politike brenda vendit, duke u bërë burim i polarizimit të thellë politik dhe publik. Qeveria u gjend përballë presionit të brendshëm nga opozita dhe opinion i publik, që e interpretonte këtë marrëveshje si të dëmshme.

Ndër sfidat më esenciale të periudhës së fundit qeverisëse katër-vjeçare, ishte situata në veri të Kosovës – niveli i tensioneve ishte ndër më të lartit që nga shpallja e pavarësisë. Së pari, në fund të vitit 2022, përfaqësuesit politikë dhe institucionalë të komunitetit serb (deputetët, anëtarët e kabinetit qeveritar, kryetarët e komunave, anëtarët e kuvendeve komunale, gjyqtarët, prokurorët dhe policët) dhanë dorëheqje kolektive, duke krijuar një vakuum të institucional dhe administrativ në komunat me shumicë serbe. Organizimi i zgjedhjeve të jashtëzakonshme lokale në prill 2023 dështoi të rivendoste stabilitetin, pasi këto zgjedhje u bojkotuan gjerësisht nga komuniteti serb. Situata u përkeqësua maksimalisht me sulmin terrorist në Banjskë në shtator të vitit 2023, kur një grup i armatosur paramilitar serb sulmoi forcat e Policisë së Kosovës, duke rezultuar me vrasjen e një rreshteri policor. Institucionet e Kosovës e cilësuan këtë incident si të orkestruar nga struktura që kishin lidhje direkte me Qeverinë e Serbisë dhe Listën Serbe.

Këto zhvillime politike, e në veçanti sukseset dhe dështimet e qeverisë Kurti, nga agenda e reformave dhe politikat e sovranitetit e deri te përplasjet me opozitën dhe krizat në veri të vendit, ofruan material të bollshëm politik që përcaktoi tonin e fushatës së zgjedhjeve të shkurtit 2025.

3. KORNIZA LIGJORE

Korniza ligjore për zgjedhjet parlamentare në Kosovë përcaktohet nga Kushtetuta e Republikës së Kosovës dhe një sërë ligjesh specifike, që së bashku rregullojnë administrimin, funksionimin dhe integritetin e zgjedhjeve. Para zgjedhjeve parlamentare të shkurtit 2025, ky kuadër ligjor pësoi disa ndryshime të rëndësishme, veçanërisht me miratimin e Ligjit të ri për Zgjedhjet e Përgjithshme në qershor të vitit 2023, si dhe ndryshimet e bëra më herët në Ligjin për Financimin e Subjekteve Politike në vitin 2022. Korniza ligjore plotësohet nga Kodi Penal dhe aktet nënligjore të nxjerra nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, duke ofruar kështu një sistem kompleks ligjor që synon garantimin e standardeve demokratike në proceset zgjedhore.

Sistemi zgjedhor në Kosovë mbetet proporcional me lista të hapura, ku e gjithë Kosova konsiderohet një zonë e vetme zgjedhore. Kuvendi ka 120 ulëse, nga të cilat 20 janë të garantuara për komunitetet joshumicë (10 për komunitetin serb dhe 10 për komunitetet e tjera). Për partitë dhe koalicionet politike që garojnë për 100 ulëset, aplikohet një prag prej 5% të votave në nivel vendi. Ky prag nuk zbatohet për subjektet politike që garojnë për ulëset e garantuara për komunitetet joshumicë.

Pavarësisht kërkesave dhe pritshmërive publike për një reformë më substanciale, ndryshimet e miratuara në vitin 2023 u përqendruan kryesisht në çështje teknike dhe administrative, duke mos adresuar disa nga mangësitë themelore që kanë ndikuar negativisht në integritetin dhe transparencën e zgjedhjeve në të kaluarën.

Një nga ndryshimet kryesore ishte zgjerimi i opsioneve të votimit jashtë vendit. Për herë të parë, u mundësua votimi fizik në misionet diplomatike dhe votimi me postë përmes kutive postare të këtyre misioneve. Kjo risi synon lehtësimin e pjesëmarrjes së diasporës, duke zvogëluar mundësinë e abuzimit me procedurat ekzistuese të votimit me postë, e cila më parë kishte

rezultuar me shumë sfida teknike dhe dyshime për manipulim.

Megjithatë, ndryshime të tjera shkaktuan shqetësime serioze. Ndryshimi më kontrovers ishte ulja e standardeve të përshtatshmërisë ligjore për kandidatët. Ligji i ri lejon kandidimin e personave të dënuar me dënime alternative apo me gjobë, duke vendosur ndalesën vetëm për ata që kanë dënim me burgim efektiv mbi një vit. Duke marrë parasysh numrin e lartë të rasteve të korrupsionit në Kosovë që përfundojnë me masa alternative, kjo dispozitë mundëson kandidimin e personave që janë të dënuar për vepra penale të lidhura me korrupsionin, duke cenuar potencialisht integritetin e Kuvendit dhe duke dobësuar besimin publik në institucionet politike.

Një tjetër ndryshim thelbësor ishte zgjerimi i votimit preferencial, deri në 10 kandidatë, i përdorur fillimisht në zgjedhjet e vitit 2007. Ndonëse qëllimi ishte zgjerimi i mundësive për qytetarët për të zgjedhur kandidatët e tyre të preferuar, ky ndryshim solli sfida praktike serioze.

Numërimi i votave preferenciale jashtë vendvotimeve, respektivisht në Qendrat Komunale të Numërimit, përveç se me pasoja direkte në shpejtësinë e administrimit të procesit, nuk solli ndonjë vlerë të shtuar për procesin – por përkundrazi, rezultoi me vonesa në publikimin e rezultateve, duke cenuar transparencën e procesit të numërimit dhe besimin e publikut.

Një ndryshim tjetër kritik lidhet me mënyrën e shkarkimit të kryesuesit dhe anëtarëve të KQZ-së. Ndryshe nga e kaluara, kur kjo kompetencë ishte diskrecion ekskluziv i Presidentit, tani ky shkarkim mund të bëhet me propozim të shumicës prej 2/3 së anëtarëve të KQZ-së, nëse konstatohet shkelje e integritetit institucional. Ndonëse në parim ky ndryshim mund të rrisë llogaridhënien, ai në praktikë rrezikon politizimin

e punës së KQZ-së dhe mund të cenojë pavarësinë e këtij institucioni, veçanërisht në situata të tensioneve të larta politike.

Në lidhje me financimin e subjekteve politike, ndryshimet e miratuara në Ligjin për Financimin e Subjekteve Politike (2022) përcaktuan rregulla më strikte për raportimin financiar dhe rritën transparencën e financimit të partive. Megjithatë, monitorimi efektiv dhe kontrolli i shpenzimeve gjatë periudhës së fushatës vazhdojnë të mbesin sfida madhore, duke krijuar hapësira për mosrespektim, sidomos në aspektin e shpenzimeve online dhe në rrjetet sociale.

Në aspektin e barazisë gjinore, kuota ligjore prej 30% vazhdoi të zbatohet për listat zgjedhore dhe ulëset në Kuvend. Edhe pse ky mekanizëm garanton një përfaqësim minimal të grave, përfshirja e tyre substanciale në vendimmarrjen politike vazhdon të jetë sfiduese. Grupe të ndryshme të shoqërisë civile dhe organizatat ndërkombëtare kanë theksuar nevojën për mekanizma më efektivë për promovimin e pjesëmarrjes së grave në nivele të larta politike dhe ekzekutive.

Në përgjithësi, ndryshimet ligjore të miratuara në prag të zgjedhjeve të vitit 2025 adresuan vetëm pjesërisht mangësitë thelbësore të sistemit zgjedhor. Pavarësisht disa përmirësimeve teknike dhe administrative, sfidat e rëndësishme për integritetin dhe transparencën e zgjedhjeve vazhduan të jenë të pranishme. Për më tepër, disa prej amendamenteve të miratuara rrezikojnë që në afatgjatë të ndikojnë negativisht në cilësinë e përfaqësimit politik, pavarësinë e institucioneve zgjedhore dhe besimin publik në proceset demokratike në Kosovë.



Sistemi zgjedhor në Kosovë mbetet proporcional me lista të hapura, ku e gjithë Kosova konsiderohet një zonë e vetme zgjedhore. Kuvendi ka 120 ulëse, nga të cilat 20 janë të garantuara për komunitetet joshumicë (10 për komunitetin serb dhe 10 për komunitetet e tjera). Për partitë dhe koalicionet politike që garojnë për 100 ulëset, aplikohet një prag prej 5% të votave në nivel vendi. Ky prag nuk zbatohet për subjektet politike që garojnë për ulëset e garantuara për komunitetet joshumicë.

4. ADMINISTRIMI I ZGJEDHJEVE

Bazuar në dispozitat kushtetuese dhe ligjore në fuqi, organi përgjegjës për përgatitjen, mbikëqyrjen, drejtimin dhe verifikimin e të gjitha veprimeve që kanë të bëjnë me procesin e zgjedhjeve, si dhe shpalljen e rezultateve të tyre, është Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Në kryerjen e përgjegjësiave dhe funksioneve të tij, ky institucion kushtetues ndihmohet nga Sekretariati i KQZ-së.

Me qëllim të përgatitjes dhe administrimit të zgjedhjeve në mënyrë sa më efektive, në nivele komunale janë themeluar Komisionet Komunale Zgjedhore, të cilat funksionojnë në bazë të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme. Këto komisione janë të themeluara në secilën prej 38 komunave të Kosovës.

Trupat përgjegjëse për administrimin e procesit zgjedhor në ditën e zgjedhjeve janë Këshillat e Vendvotimeve, të cilat përbëhen nga pesë deri në shtatë anëtarë.

Në anën tjetër, Qendrat Komunale të Numërimit (QKN) sipas përcaktimit ligjor shërbejnë si lokacione apo depo komunale ku bëhet verifikimi i votave të subjekteve politike, numërimi i fletëvotimet të kandidatëve të subjekteve politike, si dhe grumbullimi dhe publikimin e rezultateve preliminare të votave të kandidatëve. Në QKN bëhet po ashtu edhe pranimi i materialit zgjedhor, si dhe këto lokacione shërbejnë si hapësira për trajnimin e trupave menaxhuese zgjedhore.

Ndërsa, pas përfundimit të ditës së zgjedhjeve, lokacioni ku zhvillohet procesi i numërimit të votave me kusht, votave nga jashtë, si dhe proceseve eventuale të rinumërimit është Qendra e Numërimit dhe Rezultateve, e cila vepron sipas vendimeve të KQZ-së.

4.1. Puna e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është institucioni kushtetues përgjegjës për organizimin dhe adminis-

trimin e të gjitha proceseve zgjedhore në Republikën e Kosovës. Për zgjedhjet parlamentare të 9 shkurtit 2025 – të parat zgjedhje të rregullta që nga shpallja e pavarësisë – ky institucion kishte për herë të parë një periudhë të plotë përgatitore, që mundësonte planifikim të parakohshëm dhe ekzekutim të koordinuar të aktiviteteve zgjedhore. Megjithatë, zbatimi praktik i përgjegjësiave të tij u shoqërua me një sërë sfidash, vonesash dhe vendimmarrjesh të kontestuara, të cilat ngritën shqetësime për politizim të brendshëm, mungesë transparence dhe ndërhyrje në çështje teknike e administrative.

Ndonëse, dita e zgjedhjeve më 9 shkurt u zhvillua në përgjithësi në një atmosferë të qetë dhe pa incidente serioze. Megjithatë, procesi u cenua nga dështimi i sistemit elektronik të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për publikimin e rezultateve preliminare, duke e lënë publikun në terr informativ deri ditën e nesërme. Gjithashtu, ndonëse procesi i numërimit të votave për kandidatët duhej të kishte filluar menjëherë ditën pas zgjedhjeve – më 10 shkurt – për shkak të atyre që KQZ-ja i konsideron "probleme teknike dhe administrative", ky proces nuk kishte filluar deri më datë 11 shkurt 2025. Madje, edhe më 11 shkurt 2025, KQZ kishte njoftuar se procesi do të fillonte vetëm në katër komuna.

Që nga shpallja e datës së zgjedhjeve, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka zhvilluar rreth 35 mbledhje, duke miratuar vendime kyçe për organizimin e zgjedhjeve.

Procesi vendimmarrës ka qenë përgjithësisht konsensual. Vendimmarrja mbi çështje teknike dhe organizative – si numri i qendrave të votimit për votimin jashtë vendit dhe certifikimi i subjekteve politike – shpesh u shoqërua me tensione të brendshme dhe polarizim të theksuar ndërmjet anëtarëve të përfaqësuar nga partia në pushtet dhe përfaqësuesve të opozitës. Në disa raste, debati i brendshëm e tejkaloi natyrën tekniko-administrative të temave në shqyrtim, duke marrë trajta

politike që krijuan vonesa, paqartësi dhe ndikuan në qartësinë e udhëzimeve për strukturat e tjera zgjedhore.

Shembulli më domethënës është moscertifikimi fillestar i subjektit politik Lista Serbe në mbledhjen e datës 23 dhjetor 2024. Pavarësisht se Zyra për Regjistrimin e Partive Politike kishte rekomanduar certifikimin e subjektit në përputhje me kriteret ligjore, disa anëtarë të KQZ-së – veçanërisht nga radhët e Lëvizjes Vetëvendosje – votuan kundër, pa paraqitur argumente ligjore që do të justifikonin një refuzim të tillë. Vendimi u anulua më pas nga PZAP dhe u konfirmua si i kundërligjshëm nga Gjykata Supreme. Ky rast vuri në pah mungesën e një trajtimi të barabartë dhe të paanshëm të subjekteve zgjedhore dhe ndikimin e qartë të bindjeve politike në vendime që duhej të ishin thjesht procedurale.

Përplasjet politike u reflektuan edhe në vendimin për mosndarjen e fondeve publike për subjektet parlamentare për muajt janar dhe shkurt 2025. Në mbledhjen e 8 janarit, rekomandimi i Zyrës së Partive Politike për ndarjen e fondeve nuk kaloi, pasi anëtarët e opozitës nuk morën pjesë në votim, ndërsa ata nga pozita votuan kundër, për shkak të përfshirjes së Listës Serbe si përfituese. Edhe pse një anëtar propozoi që lista të votohej në mënyrë të ndarë për secilin subjekt, propozimi nuk u mbështet. Kjo qasje jo vetëm që pengoi shpërndarjen e mjeteve për të gjitha subjektet parlamentare, por krijoi precedent të rrezikshëm për politizim të përdorimit të fondeve publike.

Gjatë procesit zgjedhor, anëtarë të KQZ-së ndërhyjnë herë pas here në vendimmarrje teknike që ligjërisht i takojnë Sekretariatit të KQZ-së. Shembuj të tillë përfshijnë shqyrtimin e tenderëve, specifikave teknike të pajisjeve zgjedhore dhe modalitetet për koordinim me institucionet e tjera. Këto ndërhyrje ndikuan në efikasitetin e ekzekutivit të KQZ-së dhe krijuan tension të brendshëm në funksionimin institucional.

Në disa mbledhje u shënuan edhe raste të qarta të atakimeve publike ndaj organizatave të shoqërisë civile. Në mbledhjen e 28 janarit 2025, një nga anëtarët e KQZ-së shprehu dyshime mbi kapacitetin organizativ dhe financiar të një OJQ-je (Institutit Demokratik të Kosovës – KDI) për të akredituar mbi 300 vëzhgues të zgjedh-

jeve, duke ngritur pa fakte pretendime që synonin të delegjitimonin rolin e saj në monitorimin e procesit. Më herët, në mbledhjen e 2 dhjetorit 2024, i njëjti anëtar e cilësoi raportimin dhe deklaratat publike të kësaj organizate si “luftë hibride” dhe “dezinformata”. Këto sulme përbëjnë një tendencë shqetësuese për kufizimin e rolit të shoqërisë civile në vëzhgimin e zgjedhjeve dhe rrezikojnë të krijojnë një klimë frikësimi për organizatat kritike ndaj administratës zgjedhore.

Këto zgjedhje, si të parat zgjedhje të rregullta që nga shpallja e pavarësisë, janë zhvilluar sipas një kalendari më të qëndrueshëm, duke i dhënë KQZ-së më shumë kohë për planifikim dhe ekzekutim. Megjithatë, pavarësisht këtij avantazhi, janë shënuar vonesa në disa procese kyçe, përfshirë miratimin e përbërjes së komisioneve komunale zgjedhore, krijimin e qendrave komunale të numërimit dhe publikimin e qendrave të votimit jashtë vendit. Vonesa e fundit u ndikua nga mungesa e koordinimit me Ministrinë e Punëve të Jashtme, e cila nuk ka ofruar me kohë të dhënat e nevojshme mbi përfaqësitë diplomatike të Kosovës. Kjo e fundit krijoi perceptim publik për mungesë transparence dhe cenim të integritetit të votës jashtë vendit. Pati raportime mediatike për përfshirje të drejtpërdrejtë të zyrtarëve të lartë diplomatikë – përfshirë ambasadorin e Kosovës në Kroaci – në bartjen e fletëvotimeve pa autorizim formal.

Legjislacioni e përcakton qartë që fletëvotimet jashtë vendit duhet të barten dhe transportohen nga një kompani e cila ka ekspertizë të shquar në mbështetjen e këtij procesi. Megjithatë, KQZ-ja, si pasojë e vonesave në administrimin e procesit dhe procesit ankimor që kishte lidhur me përzgjedhjen e fituesit, u detyrua që me një vendim për këtë proces të autorizohet Sekretariati i KQZ-së, që në bashkëpunim me MPJD-në, të krijojnë ekip të përbashkët për mbledhjen dhe transportimin e fletëvotime.

KQZ-ja ndërmori disa masa teknike me qëllim rritjen e transparencës dhe kontrollit mbi procesin, por të cilat u shoqëruan me debat dhe reagime publike. Një nga sfidat teknike kryesore të këtyre zgjedhjeve ishte çështja e ngjyrës matrikuluese. Prosesi i tenderimit për këtë material u shoqërua me vonesa dhe prob-

leme cilësore, duke çuar në kthimin e furnizimit vetëm një javë para zgjedhjeve. Pavarësisht se materialet u zëvendësuan, gjatë ditës së zgjedhjeve u raportuan raste ku matrikulimi i votuesve fshihej lehtësisht, duke ngritur shqetësime mbi efektivitetin e këtij mekanizmi. Për më tepër, vetë përdorimi i matrikulimit si metodë për shënimin e votuesve u kritikua nga organizatat e shoqërisë civile dhe Agjencia për Informim dhe Privatësi, të cilat e konsideruan atë si shkelje të fshehtësisë së votës. Në anën tjetër, vendosja e kamerave në vendvotime u vlerësua si masë pozitive, ndonëse u kërkua që të garantohet plotësisht fshehtësia e votës. Një vendim tjetër problematik ishte pozicionimi i kabinave të votimit në mënyrë që ekspozonin votuesin ndaj vëzhgimit të komisionerëve. Ky vendim u kritikua gjerësisht nga organizatat e shoqërisë civile për cenim të fshehtësisë së votës dhe, pas presionit publik, KQZ u tërhoq dhe ndryshoi pozicionimin.

Megjithë sfidat dhe tensionet e përmendura, vlen të theksohet se KQZ-ja ndërmori disa përpjekje për përmirësimin e operacioneve teknike. Trajnimi i stafit komunal dhe atij të përfshirë në qendrat e votimit u zhvillua në një periudhë të kufizuar, por përfshiu për herë të parë komponentë të veçantë për administrimin e votimit jashtë vendit. Me mbështetjen e OSBE-së, u përdorën sisteme të digjitalizuara për raportimin e të dhënave dhe për menaxhimin e procesit logjistik, gjë që kontribuoi në standardizimin dhe eficiencën e disa funksioneve teknike të administratës zgjedhore.

Në përgjithësi, administrata zgjedhore ka arritur të zbatojë pjesën më të madhe të operacioneve brenda afateve të planifikuara, por me vonesa të konsiderueshme në disa procese kyçe. Përplasjet politike brenda KQZ-së, mungesa e koordinimit me institucionet e tjera dhe sfidat në përfaqësimin e drejtë të komuniteteve mbeten faktorë që kanë ndikuar në besueshmërinë dhe efikasitetin e këtij procesi.

4.2. Komisionet Komunale Zgjedhore dhe Këshillat e Vendvotimeve

Komisionet Komunale Zgjedhore janë organe, që sipas legjislacionit zgjedhor, janë përgjegjëse për zbatimin e

aktiviteteve zgjedhore brenda territorit të secilës prej 38 komunave në vend. Sipas përcaktimit ligjor, KKZ-të përbëhen nga shtatë anëtarë përgjithësisht, me këtë numër që mund të rritet nëse numri i partive që kualifikohen për të qenë pjesë e KKZ-së është më i madh. Anëtarët përzgjidhen nga KQZ-ja bazuar në nominimet e subjekteve politike që kanë kaluar pragun zgjedhor në zgjedhjet e fundit, dhe mandati i të njëjtëve fillon brenda 15 ditëve pas shpalljes së zgjedhjeve dhe përfundon 15 ditë pas certifikimit të rezultatit zgjedhor. Vendimet brenda KKZ-ve merren me aprovimin e shumicës së të gjithë anëtarëve të pranishëm.

Kompetencat kryesore të KKZ-ve ndërlidhen me administrimin e zgjedhjeve brenda territorit të komunës së tyre, duke u fokusuar më së shumti në raport me shërbimin ndaj votuesve, si dhe përgatitjet teknike të organizimit të ditës së zgjedhjeve. Mes tjerash, KKZ-të ofrojnë informata për votuesit, nominojnë trajnerë për trajnimin e stafit zgjedhor, caktimin e anëtarëve dhe kryesuesve të KVV-ve, lokacionet e qendrave të votimit dhe vendvotimeve, sfidimin dhe ndryshimin e listës përfundimtare të votuesve, përkatësisht heqjen e personave të vdekur, pranimin e materialeve të ndjeshme dhe jo të ndjeshme nëpër depot e tyre, e të tjera të kësaj natyre.

KKZ-të luajnë një rol kyç në shërbimin ndaj votuesve, përgatitjen e logjistikës, nominimin e trajnerëve për komisionerët, caktimin e lokacioneve të qendrave të votimit dhe organizimin e shpërndarjes së materialeve zgjedhore. Megjithatë, gjatë këtyre zgjedhjeve, janë evidentuar raste të mungesës së koordinimit ndërmjet nivelit qendror të KQZ-së dhe KKZ-ve, gjë që ka rezultuar në vonesa në bartjen e të dhënave dhe në mosrespektimin e afateve për përgatitjen logjistike të vendvotimeve. Në disa raste, KKZ-të nuk kanë marrë me kohë udhëzime të qarta për proceset teknike apo kanë vepruar mbi bazë interpretimeve të pasakta të vendimeve të KQZ-së.

KQZ u përball me sfida të shumta edhe për shkak të bojkotit dhe dorëheqjeve të përfaqësuesve serbë në komunat veriore. Për ta kompensuar këtë mungesë, KQZ caktoi përkohësisht zyrtarë nga komuna të tjera, një vendim ky që ishte operacionalisht i domosdoshëm,

por që në thelb bie ndesh me dispozitat ligjore për përfaqësim të drejtë dhe përbërje nga territori i komunës përkatëse.

Gjatë procesit, KQZ miratoi një sërë vendimesh mbi numrin dhe shpërndarjen e qendrave të votimit dhe vendvotimeve. Në total, u emëruan mbi 15 mijë komisionerë për të menaxhuar procesin zgjedhor brenda vendit dhe mbi 150 për qendrat e votimit në përfaqësitë diplomatike jashtë Kosovës. Gjithashtu, u emëruan më shumë se 2,300 anëtarë në grupet e numërimit të votave në 38 Qendrat Komunale të Numërimit (QKN).

Në këto zgjedhje u shënuan ndryshime në strukturën e Këshillave të Vendvotimeve, përfshirë shtimin e një komisioneri të dedikuar për raportimin e të dhënave statistikore dhe zëvendësimin e komisionerit përgjegjës për rutinën e votimit, pozitë që tradicionalisht kishte rol kyç në parandalimin e parregullsive në momentin e hedhjes së fletëvotimit.

Ky ndryshim strukturor, i arsyetuar me nevojën për përmirësimin e grumbullimit të të dhënave, nuk prodhoi rezultate konkrete në terren. Gjatë ditës së zgjedhjeve, nuk u prodhua apo publikua në kohë reale asnjë statistikë përmblledhëse e dobishme mbi pjesëmarrjen në zgjedhje, përtej atyre të publikuara edhe në ciklet paraprake zgjedhore, duke vënë në dyshim efektivitetin e pozitës së re. Edhe më shqetësuese ishte mungesa e komisionerit të dedikuar për rutinën e votimit, që si faktor u lidh me një sërë incidentesh të raportuara, përfshirë fletëvotime të pavulosura ose të kopjuara të cilat përfunduan në kuti.

Në anën tjetër, në disa komuna, partitë politike nominuan përfaqësues nga komunitete të tjera, duke krijuar tensione mbi ndarjen e vendeve në Këshillat e Vendvotimeve (KVV). Në disa raste, partitë e komuniteteve jo-shumicë shprehën pakënaqësi për përfaqësimin e tyre në komisionet komunale zgjedhore. Ankesat e tyre pranë Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) u aprovuan, duke detyruar KQZ-në të rishikojë përbërjen e këtyre komisioneve. Ky zhvillim tregoi nevojën për një mekanizëm më transparent dhe gjithëpërfshirës për ndarjen e vendeve në administratën zgjedhore.

Trajnimet për shumicën e komisionerëve filluan vetëm tetë ditë para ditës së votimit, që si periudhë që u konsiderua e pamjaftueshme për të garantuar përgatitjen e nevojshme për një administrim korrekt të ditës së zgjedhjeve, veçanërisht në një kontekst kur janë aplikuar ndryshime të reja në kuadrin ligjor.

Megjithëse KKZ-të dhe KVV-të arritën në shumicën e rasteve të realizojnë detyrat bazë të ditës së votimit, mungesa e përgatitjes afatgjate, problemet me përfaqësimin e komuniteteve jo-shumicë, ndryshimet e pa-analizuara në strukturën e vendvotimeve dhe dobësitë në koordinim me KQZ-në janë probleme që truptat menaxhuese duhet t'i analizojnë më detajisht.

4.3. Puna në Qendrat Komunale të Numërimit

Qendrat Komunale të Numërimit (QKN) përbëjnë një risi në procesin zgjedhor në Kosovë, të vënë për herë të parë në funksion të plotë gjatë zgjedhjeve parlamentare të këtij viti, si pjesë e reformës që synonte zhvendosjen e numërimit të votave për kandidatët nga vendvotimi në një hapësirë të centralizuar komunale. Sipas Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe Rregullores Zgjedhore për QKN-të, këto qendra shërbejnë për numërimin e votave preferenciale të kandidatëve, pranimin dhe verifikimin e materialit zgjedhor nga vendvotimet, si dhe për transmetimin e të dhënave drejt Qendrës së Numërimit dhe Rezultateve (QNR). Ato janë të vendosura në hapësira të mëdha si palestra apo salla sportive dhe administrohen nga Komisionet Komunale të Zgjedhjeve (KKZ), me staf të përzgjedhur nga KQZ dhe me skema të miratuara paraprakisht për funksionimin e tyre.

Zhvillimi i këtij modeli kishte për qëllim parandalimin e manipulimeve me votat preferenciale nga komisionerët në vendvotim, si dhe përmirësimin e saktësisë së të dhënave. Por përkundër këtij qëllimi, zbatimi praktik i QKN-ve nxori në pah probleme serioze në organizim, ekzekutim dhe mbikëqyrje, që në shumë raste komprometuan besueshmërinë e procesit dhe zgjatën pa nevojë përmbylljen e rezultateve.

Vet puna në Qendrat Komunale të Numërimit ishte një përpjekje ambicioze për të avancuar integritetin e procesit zgjedhor, por që në praktikë u përball me mungesë përgatitjesh, probleme sistematike në trajnim, përkrahje të dobët logjistike dhe mbikëqyrje të mangët nga KKZ-të apo vet KQZ-ja. Në shumë raste QKN-të u shndërruan në hallkën më të dobët të zinxhirit të administrimit zgjedhor, duke rezultuar me tejzgjatje të procesit.

Gjatë monitorimit të punës në disa prej QKN-ve, janë evidencuar një sërë problematikash që lidhen me mungesë të qasjes standarde në trajtim të materialeve, si dhe me mungesë serioze të trajnimit të stafit të angazhuar për numërim. Në shumë raste, anëtarët e ekipeve të numërimit nuk kishin njohuri të mjaftueshme për mënyrën e raportimit të të dhënave në formularët përkatës, sidomos në rastet kur ka mospërputhje midis fletëvotimeve dhe listave të nënshkrimeve të votuesve. Në mungesë të udhëzimeve të qarta për menaxhimin e këtyre rasteve, procesi ndalej për periudha të gjata, duke krijuar konfuzion dhe vonesa.

Një tjetër sfidë kritike ishte mungesa e infrastrukturës teknike, veçanërisht lidhja jo e qëndrueshme e internetit, që në shumë QKN i pamundësoi ekipet të transmetonin të dhënat në kohë reale drejt platformës qendrore. Në disa raste, ky faktor bëri që kutitë të mbeleshin të papërpunuara për orë të tëra, duke detyruar stafin të rikthehej në qendër ditën tjetër për ta përmbyllur procesin.

Monitorimi i DnV-së ka evidencuar gjithashtu tensione të përsëritura midis anëtarëve të ekipeve të numërimit dhe vëzhguesve, veçanërisht në raste kur vëzhguesit kërkonin qasje në dokumentacionin mbështetës ose pretendonin mospërputhje.

Për më tepër, mënyra se si KQZ-ja reagoi ndaj raporteve për vonesa ose përparim të ngadaltë ishte shpesh improvizuese dhe pa plan të qartë rezervë. Në vend se të ndërmerreshin masa të menjëhershme për shtimin e kapaciteteve ose për ndërhyrje teknike, në disa raste justifikimi zyrtar i vonesave ishte “për shkak të moslidhjes së kamerave me ekranet”, duke krijuar përshtypjen publike se në kohën kur një vend i tërë

pret rezultatet, procesi zvarritet për arsye krejtësisht dytësore.

Një nga qëllimet kryesore të krijimit të QKN-ve ishte eliminimi i manipulimeve në vendvotim, duke zhvendosur numërimin në një ambient më të kontrolluar. Megjithatë, praktika tregoi se ndryshimi i vendit të numërimit nuk ishte i mjaftueshëm për të siguruar saktësinë dhe besueshmërinë e plotë të rezultateve. Rasti i komunës së Vushtrrisë është ilustrues në këtë drejtim, ku nga verifikimi i rezultateve në QKN u identifikuan mospërputhje në rezultatet për kandidatët në 35 vendvotime, ndërsa vetëm në 15 nga 96 vendvotimet e komunës nuk u konstatua asnjë dallim mes rezultateve të raportuara dhe atyre të rinumëruara. Këto të dhëna dëshmojnë se problemi nuk qëndron vetëm te vendi i numërimit, por tek kapaciteti dhe ndershmëria e administratës zgjedhore që e realizon atë proces. Me gjithë përdorimin e kamerave, praninë e vëzhguesve dhe kostot më të larta operacionale, ky model nuk arriti të garantojë përmirësim të ndjeshëm të saktësisë dhe integritetit të procesit.

4.4. Puna në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve

Qendra e Numërimit dhe Rezultateve (QNR) është njësi funksionale brenda Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), përgjegjëse për administrimin e fazës së përmbylljes së zgjedhjeve. Ajo përbën hallkën përfundimtare në procesin e verifikimit, numërimit dhe tabulimit të rezultateve përfundimtare.

Bazuar në Rregulloren Zgjedhore Nr. 14/2024, QNR është përgjegjëse për pranimin dhe kontrollin e të gjitha materialeve zgjedhore nga vendvotimet dhe Qendrat Komunale të Numërimit (QKN), për numërimin e votave me kusht dhe votave nga jashtë vendit, për trajtimin e rasteve të mospërputhjeve në rezultate, si dhe për realizimin e çdo rinumërimi të kërkuar nga vetë KQZ apo me vendim të institucioneve tjera relevante. QNR gjithashtu ka rol kyç në përgatitjen e rezultateve përfundimtare për certifikim dhe në skanimin e listës përfundimtare të votuesve për verifikime të mëvonshme.

Pas përfundimit të ditës së votimit, kutitë dhe materialet zgjedhore të ardhura nga vendvotimet dhe QKN-të u dorëzuan në QNR për verifikim. Procesi i pranimit përfshinte kontrollin e formularëve të rezultateve, krahasimin e tyre me numrin e votuesve të nënshkruar në listat e votimit, si dhe verifikimin e përputhjes së të dhënave numerike. Ky proces rezultoi të ishte i rregullt, por ndonjëherë i ngadalshëm dhe i ngarkuar me probleme teknike dhe organizative.

Përveç disa vonesave, janë evidentuar edhe probleme me mosorganizimin e hapësirës fizike, çka shkaktonte ndërçellogjistike dhe bllokime të panevojshme në qarkullimin e ekipeve brenda qendrës. Po ashtu, janë regjistruar raste të mosmarrëveshjeve dhe përplasjeve verbale mes stafit profesional të angazhuar në QNR dhe anëtarëve të KQZ-së. Këto raste përfshijnë përplasje të hapura rreth ritmit të punës dhe metodologjisë së ndjekur, sidomos lidhur me çështjen e votave të pavlefshme. Ndërhyrjet e anëtarëve të caktuar të KQZ-së, veçanërisht atyre nga radhët e partisë në pushtet, kanë shkaktuar tensione të cilat vënë në dyshim ndarjen funksionale ndërmjet vendimarrjes politike dhe punës teknike të administratës zgjedhore.

Gjatë punës në QNR dhe me përfshirjen e Prokurorisë, u identifikuan gjithashtu parregullsi. Specifikisht, u vendos që të rinumërohen 50 vendvotime, 35 prej të cilave në komunën e Vushtrrisë dhe 15 vendvotime të tjera nga komuna të ndryshme, ku u konstatuan mospërputhje mes numrit të nënshkrimeve në listat e votuesve dhe numrit të fletëvotimeve në kuti. Ndërsa, në komunën e Vushtrrisë u vërejtën parregullsi specifike lidhur me rezultatet e votave preferenciale të kandidatëve. Gjatë shqyrtimit të formularëve doli se për 35 vendvotime të kësaj komune, rezultatet e kandidatëve nga radhët e Lidhjes Demokratike të Kosovës, kishin dallime ose mospërputhje të theksuara.

Procesi i rinumërimeve, ndonëse i domosdoshëm për integritetin e rezultateve zgjedhore, shtoi ngarkesën mbi QNR dhe zgjati afatin e përmbylljes së procesit zgjedhor. Stafi i QNR-së u angazhua intensivisht për të kryer numërimin e kutive shtesë, ndërkohë që vazhonte edhe trajtimi i materialeve tjera si fletëvotimet me kusht dhe votat nga jashtë vendit.



Bazuar në Rregulloren Zgjedhore Nr. 14/2024, QNR është përgjegjëse për pranimin dhe kontrollin e të gjitha materialeve zgjedhore nga vendvotimet dhe Qendrat Komunale të Numërimit (QKN), për numërimin e votave me kusht dhe votave nga jashtë vendit, për trajtimin e rasteve të mospërputhjeve në rezultate, si dhe për realizimin e çdo rinumërimi të kërkuar nga vetë KQZ apo me vendim të institucioneve tjera relevante. QNR gjithashtu ka rol kyç në përgatitjen e rezultateve përfundimtare për certifikim dhe në skanimin e listës përfundimtare të votuesve për verifikime të mëvonshme.

4.5. Certifikimi i subjekteve politike dhe kandidatëve të tyre

Procesi i certifikimit të subjekteve politike dhe kandidatëve të tyre për zgjedhjet parlamentare të 9 shkurtit 2025 u zhvillua gjatë një periudhe 102-ditore, nga 1 shtatori deri më 11 dhjetor 2024. Gjatë kësaj periudhe, 28 subjekte politike paraqitën aplikacionet për certifikim, me një numër të përgjithshëm prej 1,280 kandidatësh.

KQZ miratoi aplikacionet e të gjitha subjekteve politike, me përjashtim të rastit të Listës Serbe, i cili u shndërrua në një episod të këtyre zgjedhjeve, që pati pasoja

edhe mbi perceptimin për pavarësinë e administratës zgjedhore. Në mbledhjen e datës 23 dhjetor 2024, KQZ refuzoi certifikimin e Listës Serbe, pavarësisht se Zyra për Regjistrimin e Partive Politike kishte konstatuar se subjekti përmbushte të gjitha kriteret ligjore të parashikuara me ligj dhe rregullore. Vendimi u mor përmes votimit politik të anëtarëve të KQZ-së, ku përfaqësuesit nga partia në pushtet votuan kundër, pa paraqitur arsye të bazuara në dispozita ligjore ose dokumentacion përkatës, derisa përfaqësuesit nga radhët e partive opozitare abstenuan.

Vendimi u ankimua nga subjekti në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtesa (PZAP), i cili e anuloi vendimin e KQZ-së si të pabazuar ligjshërisht. Vendimi i PZAP-së u konfirmua më tej edhe nga Gjykata Supreme, duke forcuar bindjen se refuzimi ishte politik dhe jo ligjor. Ky rast shpërfaqti tendencën e përzjerjes së konsideratave politike në vendimmarrjen e KQZ-së.

Në zgjedhje morën pjesë gjithsej 28 subjekte politike, prej të cilave 20 ishin parti politike; 5 ishin koalicionë parazgjedhore; 2 ishin iniciativa qytetare; ndërsa 1 ishte kandidat i pavarur. Nga këto, 8 ishin të spektrit shqiptar, 6 përfaqësonin komunitetin serb, 6 ishin nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptas, 4 boshnjake, 3 turke dhe 1 gorane. Tri nga partitë kryesore parlamentare (LVV, PDK dhe LDK) garuan në mënyrë të pavarur, ndërsa AAK hyri në koalicion me parti më të vogla dhe iniciativa qytetare.

Të gjitha subjektet politike parlamentare respektuar kuotën prej 30% për përfaqësimin gjinor në listat e kandidatëve. Megjithatë, përfaqësimi i grave në listat tregon se kjo përmbushje ka qenë kryesisht formale dhe në nivelin minimal të kërkuar me ligj. Për shembull, Lëvizja Vetëvendosje (LVV) ka përfshirë 41 gra në listën e saj zgjedhore (37%), pasuar nga PDK-ja me 38 gra (34%), LDK-ja me 37 gra (33%) dhe koalicioni AAK-Nisma me 36 gra (32%).

Ndërsa këto shifra janë pothuajse në pragun minimal të kuotës, mungesa e barazisë në listat e kandidatëve tregon se përfshirja e grave në politikë vazhdon të mbetet e kufizuar nga struktura dhe vendimmarrja e brendshme partiake. Megjithatë, rritja graduale e për-

faqësimit të grave mund të shihet si një tregues pozitiv që subjektet politike po fillojnë të kuptojnë rëndësinë e përfaqësimit gjinor në ndërtimin e një demokracie gjithëpërfshirëse.

Procesi i certifikimit të kandidatëve u ndikua dukshëm nga ndryshimet ligjore të miratuara në vitin 2023, të cilat ulën kriteret e përshtatshmërisë juridike për pjesëmarrje në zgjedhje. Sipas ndryshimeve të reja, e drejta për të kandiduar ndalohet vetëm për personat e dënuar me burgim efektiv mbi një vit, duke përjashtuar nga ndalesa personat e dënuar me kusht, gjobë ose dënime alternative, edhe në rastet kur bëhet fjalë për vepra të ndërlidhura me korrupsionin apo abuzime me detyrën zyrtare.

Si rrjedhojë, janë paraqitur raste ku në listat e kandidatëve figurojnë persona që janë ende nën hetim penal, në proces gjyqësor, ose që janë dënuar, por me dënime që nuk përfshijnë burgim efektiv mbi një vit.

Për më tepër, ky ndryshim ligjor është një hap prapa në përpjekjet për të luftuar korrupsionin politik dhe për të pastruar listat zgjedhore nga individë me rekorde penale, veçanërisht në një kontekst ku shumica e rasteve të korrupsionit në Kosovë janë ndëshkuar me dënime me kusht ose masa alternative. Mungesa e një standardi etik më të lartë për përfaqësim i lejon sistemit të prodhojë legjitimitet formal për kandidatë që, ndonëse të pranueshëm ligjërisht, mund të jenë të papërshtatshëm në aspektin e integritetit.



Të gjitha subjektet politike parlamentare respektuar kuotën prej 30% për përfaqësimin gjinor në listat e kandidatëve. Megjithatë, përfaqësimi i grave në listat tregon se kjo përmbushje ka qenë kryesisht formale dhe në nivelin minimal të kërkuar me ligj. Për shembull, Lëvizja Vetëvendosje (LVV) ka përfshirë 41 gra në listën e saj zgjedhore (37%), pasuar nga PDK-ja me 38 gra (34%), LDK-ja me 37 gra (33%) dhe koalicioni AAK–Nisma me 36 gra (32%).

4.6. Certifikimi i listës së votuesve dhe Shërbimi i Votuesve

Lista e votuesve për zgjedhjet parlamentare të 9 shkurtit 2025 është përpiluar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi dhe në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse për administrimin e të dhënave të gjendjes civile. Burimi primar i të dhënave për këtë proces ishte Regjistri Qendror Civil (RQC), i administruar nga Agjencia për Regjistrim Civil (ARC) brenda Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Në funksion të verifikimit dhe përditësimit të të dhënave mbi zgjedhësit e ligjshëm, KQZ mori tre ekstrakte të ndara nga Departamenti i Gjendjes Civile (DGJC) dhe Departamenti për Prodhimin e Dokumenteve (DPD). Këto të dhëna iu nënshtruan një procesi të kontrollit dhe krahasimit ndërinstitutional, për të eliminuar nga lista personat që nuk kishin të drejtë vote.

Lista përfundimtare e votuesve përfshinte gjithsej 2,075,868 votues, që përbën një rritje prej 174,888 votuesish krahasuar me zgjedhjet lokale të vitit 2021. Kjo rritje përfshin edhe 125,852 votues të rinj që kishin mbushur moshën 18 vjeç ndërmjet dy proceseve zgjed-

hore. Numri i votuesve të regjistruar brenda Kosovës ishte 1,970,944, ndërsa 104,924 votues ishin regjistruar për të votuar nga jashtë vendit.

Megjithëse KQZ përmbushi detyrimet procedurale në lidhje me hartimin dhe publikimin e listës, “inflacioni” i vazhdueshëm i saj në raport me të dhënat reale të popullsisë, vazhdon të jetë një prej sfidave më serioze që ndikon në besueshmërinë publike ndaj integritetit të procesit zgjedhor. Ky shqetësim është ngritur vazhdimisht edhe nga misionet ndërkombëtare të vëzhgimit, përfshirë atë të Bashkimit Evropian.

Sidoqoftë, KQZ ndërmori disa hapa për pastrimin e listës së votuesve, në bashkëpunim me institucionet relevante. 160 votues u larguan nga lista e votuesve për shkak të humbjes së zotësisë për të vepruar – sipas listës së ofruar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK). Tutje, 915 persona të vdekur u larguan nga lista, pas konfirmimit të tyre nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) dhe Departamenti i Pensioneve (DP). Në këtë drejtim, edhe një numër i personave mbi 100 vjeç, të cilët nuk figuronin në regjistrat aktivë të dokumentacionit civil, u përjashtuan me vendim të veçantë të KQZ-së. Këto ndërhyrje ishin të domosdoshme për të rritur saktësinë e listës, megjithatë numri total i votuesve të regjistruar vazhdon të tejkalojë ndjeshëm numrin e popullsisë së vendit.

Në kuadër të përgatitjes së listës përfundimtare dhe të garantimit të të drejtës për informacion të votuesve, KQZ ofroi Shërbimin e Votuesve për periudhën 29 gusht – 26 dhjetor 2024. Ky shërbim u mundësoi qytetarëve që të verifikonin të dhënat e tyre personale në listën e votuesve; të aplikonin për ndryshim të qendrës së votimit brenda komunës; apo të kërkonin përfshirjen apo korrigjimin e të dhënave nëse nuk ishin të përfshirë fare në listë. Gjatë kësaj periudhe, ishin pranuar 17,219 kërkesa për ndërrim të qendrës së votimit, prej të cilave 16,503 janë aprovuar, ndërsa 716 janë refuzuar. Pavarësisht kësaj përpjekjeje, në disa raste janë evidentuar edhe raste të mosqartësive procedurale dhe komunikimi jo të plotë me qytetarët, veçanërisht në komuna më të mëdha, ku kapacitetet administrative kanë rezultuar të pamjaftueshme për të përballuar fluksin e kërkesave në afat optimal.

Për organizimin
e procesit të
votimit, KQZ
ka miratuar
gjithsej



903

qendra të votimit

me një total prej

2,533

vendvotimesh të rregullta.



Përveç tyre, janë funksionalizuar edhe 38 qendra votimi me kusht, me gjithsej 56 vendvotime , për të mbuluar rastet e veçanta, siç përcaktohen në bazë të legjislacionit në fuqi.



Deçan

NR. I VOTUESVE



40,976

QENDRA VOTIMI



14

VENDVOTIME



50



Gjakovë

NR. I VOTUESVE



119,237

QENDRA VOTIMI



36

VENDVOTIME



145



Glogoc

NR. I VOTUESVE



56,703

QENDRA VOTIMI



31

VENDVOTIME



72



Gjilan

NR. I VOTUESVE



103,616

QENDRA VOTIMI



37

VENDVOTIME



129



Dragash

NR. I VOTUESVE



40,263

QENDRA VOTIMI



33

VENDVOTIME



56



Istog

NR. I VOTUESVE



50,276

QENDRA VOTIMI



21

VENDVOTIME



60



Kaçanik

NR. I VOTUESVE



33,157

QENDRA VOTIMI



21

VENDVOTIME



46

		NR. I VOTUESVE  50,706	QENDRA VOTIMI  21	VENDVOTIME  62
		NR. I VOTUESVE  47,406	QENDRA VOTIMI  16	VENDVOTIME  58
		NR. I VOTUESVE  33,775	QENDRA VOTIMI  28	VENDVOTIME  50
		NR. I VOTUESVE  81,482	QENDRA VOTIMI  32	VENDVOTIME  105
		NR. I VOTUESVE  13,876	QENDRA VOTIMI  18	VENDVOTIME  26
		NR. I VOTUESVE  64,341	QENDRA VOTIMI  33	VENDVOTIME  84
		NR. I VOTUESVE  9,820	QENDRA VOTIMI  18	VENDVOTIME  22
		NR. I VOTUESVE  25,883	QENDRA VOTIMI  14	VENDVOTIME  33
		NR. I VOTUESVE  58,338	QENDRA VOTIMI  35	VENDVOTIME  79
		NR. I VOTUESVE  115,679	QENDRA VOTIMI  24	VENDVOTIME  132
		NR. I VOTUESVE  84,023	QENDRA VOTIMI  47	VENDVOTIME  110

 Prishtinë	 NR. I VOTUESVE 212,515	 QENDRA VOTIMI 54	 VENDVOTIME 258
 Prizren	 NR. I VOTUESVE 182,939	 QENDRA VOTIMI 76	 VENDVOTIME 236
 Skenderaj	 NR. I VOTUESVE 53,329	 QENDRA VOTIMI 33	 VENDVOTIME 71
 Shtime	 NR. I VOTUESVE 27,329	 QENDRA VOTIMI 15	 VENDVOTIME 33
 Shtërpçë	 NR. I VOTUESVE 12,864	 QENDRA VOTIMI 9	 VENDVOTIME 17
 Suharekë	 NR. I VOTUESVE 68,101	 QENDRA VOTIMI 34	 VENDVOTIME 87
 Ferizaj	 NR. I VOTUESVE 118,288	 QENDRA VOTIMI 48	 VENDVOTIME 152
 Viti	 NR. I VOTUESVE 49,054	 QENDRA VOTIMI 30	 VENDVOTIME 63
 Vushtrri	 NR. I VOTUESVE 73,713	 QENDRA VOTIMI 32	 VENDVOTIME 96
 Zubin Potok	 NR. I VOTUESVE 6,843	 QENDRA VOTIMI 12	 VENDVOTIME 14
 Zvečan	 NR. I VOTUESVE 7,203	 QENDRA VOTIMI 6	 VENDVOTIME 11

 Malishevë	 NR. I VOTUESVE  55,154	QENDRA VOTIMI  35	VENDVOTIME  72
 Junik	 NR. I VOTUESVE  5,292	QENDRA VOTIMI  1	VENDVOTIME  7
 Mamushë	 NR. I VOTUESVE  4,699	QENDRA VOTIMI  1	VENDVOTIME  5
 Hani i Elezit	 NR. I VOTUESVE  8,641	QENDRA VOTIMI  4	VENDVOTIME  12
 Graçanicë	 NR. I VOTUESVE  22,819	QENDRA VOTIMI  13	VENDVOTIME  31
 Ranillug	 NR. I VOTUESVE  5,069	QENDRA VOTIMI  7	VENDVOTIME  10
 Partesh	 NR. I VOTUESVE  4,882	QENDRA VOTIMI  3	VENDVOTIME  7
 Kllokot	 NR. I VOTUESVE  3,872	QENDRA VOTIMI  5	VENDVOTIME  8
 Mitrovicë e Veriut	 NR. I VOTUESVE  18,781	QENDRA VOTIMI  6	VENDVOTIME  24

 Gjithsej	 NR. I VOTUESVE  1,970,944	QENDRA VOTIMI  903	VENDVOTIME  2,533
--	---	--	--

4.7. Votimi jashtë vendit

Për shkak të ndryshimeve ligjore dhe natyrës komplekse të procesit, votimi jashtë Kosovës ishte një nga çështjet më të diskutuara në këto zgjedhje. Periudha e aplikimit për regjistrim si votues jashtë vendit zgjati nga 29 gushti deri më 26 dhjetor 2024. Aplikimi mund të bëhej në dy mënyra: përmes platformës elektronike të KQZ-së ose duke dërguar me postë dokumentet e kërkuara, sipas përcaktimeve të Rregullores nr. 17/2024.

Pas verifikimit të dokumentacionit dhe trajtimit të kundërshtimeve nga Paneli për Ankesa dhe Parashpresa, KQZ përpiloi listën përfundimtare të votuesve jashtë vendit me 104,924 votues të regjistruar jashtë vendit. Në përputhje me nenin 96, paragrafi 9 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, këta votues u larguan nga lista e votuesve brenda Kosovës për të shmangur votimin e dyfishtë.

Gjatë regjistrimit, votuesit jashtë vendit zgjedhën paraprakisht mënyrën e votimit, që përfshinte votim me postë – në Kosovë apo në fahet postare të hapura jashtë vendit – ose votim fizik në përfaqësitë diplomatike. Sipas KQZ-së, nga 104,924 votues të diasporës, 20,416 (19.5%) preferuan të votojnë fizikisht në misionet diplomatike, ndërsa 84,508 zgjedhën votimin me postë.

KQZ planifikoi hapjen e vendvotimeve në 19 shtete (gjithsej 43 vendvotime në 16 ambasada dhe 14 konsullata) për votimin fizik më 8 shkurt 2025. Megjithatë, për shkak të numrit shumë të ulët të votuesve të regjistruar në disa lokalitete dhe sfidave logjistike, KQZ anuloi 5 vendvotime të planifikuara në diasporë, duke udhëzuar votuesit e atyre zonave të votonin përmes postës.

Procesi i votimit me postë u bazua në dërgimin e fletëvotimeve në zarfe të veçanta drejt Kosovës ose drejt kutive postare të hapura nga KQZ në disa vende. Zarfet me fletëvotime duhej të dërgoheshin brenda afatit të përcaktuar, me kusht që të mbanin vulën postare brenda periudhës së lejuar të votimit. KQZ, me asistencën e misioneve diplomatike, kishte hapur edhe vetë kuti postare jashtë Kosovës për të pranuar dërgesat e votave, si një masë për të lehtësuar dhe përshpejtuar ardhjen e tyre.

Gjatë periudhës së regjistrimit, KQZ pranoi aplikime nga 75 shtete të ndryshme. Përqendrimi gjeografik i diasporës kosovare u konfirmua edhe një herë, me Gjermaninë dhe Zvicrën që së bashku përbënin mbi 70% të aplikimeve, me përkatësisht 44,774 dhe 27,248 aplikues.

Nga numri i përgjithshëm i të regjistruarve, pjesëmarrja faktike ishte shumë e lartë, me rreth 80%. Sipas të dhënave të KQZ, 15,352 qytetarë të diasporës votuan fizikisht në misionet diplomatike dhe 68,712 votuan me postë. Kjo do të thotë që shumica dërrmuese e votuesve të regjistruar e realizuan të drejtën e tyre të votës. Vetëm rreth 20% e atyre në listën e votuesve jashtë vendit nuk morën pjesë.

Në total, KQZ-ja pranoi afro 69 mijë zarfe me fletëvotime nga diaspora. Prej tyre, pas vlerësimit në QNR, u aprovuan rreth 63 mijë zarfe, ndërsa më pak se 5 mijë u refuzuan si të pavlefshme. Arsytet e refuzimit ishin të dokumentuara dhe kryesisht lidhen me parregullsi teknike apo procedurale. Për shembull, qindra zarfe u shpallën të pavlefshme sepse votuesit përkatës kishin zgjedhur të votonin fizikisht në ambasada. Po ashtu, u konstatuan raste të dërgimit të shumëfishtë të zarfeve nga i njëjti votues, si dhe zarfe pa vulë postare ose me probleme tjera formale, të cilat u refuzuan.

Dërgesat me fletëvotime të diasporës vazhduan të mbledhen dhe të konfirmohen edhe pak ditë pas 9 shkurtit. Deri më 7 shkurt 2025, shërbimi postar kishte konfirmuar 50,226 zarfe të pranuar në kutitë postare jashtë Kosovës dhe ndërkohë 40,859 prej tyre tashmë kishin arritur fizikisht në Kosovë. Kjo nënkupton se mijëra vota nga jashtë vendit ende po transportoheshin drejt qendrës së numërimit edhe gjatë dhe pas ditës së zgjedhjeve. Si rezultat, numërimi përfundimtar i votave me postë dhe atyre të votuara jashtë vendit filloi me vonesë. Zyrtarisht, numërimi i votave të diasporës filloi më 26 shkurt 2025, më shumë se dy javë pas ditës së zgjedhjeve, pasi fillimisht u përfundua numërimi i votave brenda Kosovës (të rregullta) dhe u skanuan listat e votuesve për të eliminuar dublimet e mundshme.

Një aspekt kritik i administrimit të votës së diasporës këtë vit ishte çështja e transportimit të pakove me

vota drejt Kosovës. KQZ fillimisht shqyrtoi opsionin e angazhimit të një kompanie private logjistike për të mbledhur dhe dorëzuar zarfet e votimit nga kutitë postare jashtë vendit në Kosovë, praktikë e përdorur ose sugjeruar edhe më herët për të përshpejtuar procesin. Mirëpo, në fund kjo nuk u realizua, pasi që KQZ dështoi të angazhojë një operator privat për tërheqjen e votave nga jashtë. Për pasojë, me vendim të datës 21 janar 2025, KQZ autorizoi ushtruesin e detyrës së Drejtorit të Sekretariatit të KQZ që të formonte një ekip të posaçëm transporti. Ky ekip u përbë nga 9 zyrtarë të KQZ-së dhe 7 zyrtarë të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës (MPJD), të cilët u ngarkuan me detyrën e mbledhjes së zarfeve me vota nga kutitë postare nëpër botë dhe sjelljen e tyre të sigurtë në Kosovë. Vetë KQZ pranoi se sfidat në prokurim dhe organizimin logjistik, përfshirë operacionet e shpërndarjes dhe tërheqjes së votave me postë, shkaktuan vonesa të mëdha në përgatitjet zgjedhore.

Vendimi për të përfshirë MPJD-në drejtpërdrejt në procesin e transportimit të votave nga diaspora ngjalli debate mbi integritetin e procesit. Organizatat e shoqërisë civile dhe disa subjekte opozitare reagues, duke shprehur shqetësim se përfshirja e një ministrie qeveritare në administrimin e votave mund të cenonte paanshmërinë e zgjedhjeve. MPJD është pjesë e ekzekutivit dhe drejtohet nga një ministër politike, prandaj prania e stafit të kësaj ministrie krijoi perceptimin e ndërhyrjes së politikës në një proces që duhej administruar nga trupa të pavarura zgjedhore. Në thelb, kritika kryesore ishte se KQZ nuk siguroi transparencë të mjaftueshme se si u menaxhua ekipi i përbashkët KQZ-MPJD, respektivisht lidhur me atë se cilat ishin protokollet e ruajtjes së zarfeve, kush kishte akses tek to gjatë udhëtimit, dhe si dokumentohej zinxhiri i posedimit deri në dorëzimin në QNR.

Zgjedhjet e vitit 2025 ishin të parat që u zhvilluan pas një reforme ligjore zgjedhore gjithëpërfshirëse. Ligji i ri për Zgjedhjet e Përgjithshme (Ligji nr. 08/L-228) dhe rregulloret e reja të KQZ-së (përfshirë Rregulloren 17/2024) sollën risi si votimi në misionet diplomatike, regjistrimi elektronik i diasporës, kamera në vendvotime etj. Sa i përket votimit jashtë vendit, shumica e parashikimeve ligjore u zbatuan formalisht. KQZ arriti

të regjistrojë një numër rekord votuesish nga diaspora brenda afateve ligjore, duke respektuar procedurat e verifikimit dhe të drejtën e ankimit. Lista e veçantë e votuesve jashtë Kosovës u certifikua unanimisht nga anëtarët e KQZ-së.

Megjithatë, zbatimi praktik nxori në pah edhe mangësi apo paqartësi në kornizën e re. Disa vendime teknike u morën me vonesë nga KQZ, për shkak të natyrës komplekse të procesit dhe ndonjëherë mungesës së koordinimit ndërinstitucional. Për shembull, caktimi i qendrave të votimit në diasporë u vonua sepse KQZ hasi vështirësi në sigurimin me kohë të informatave nga MPJD-ja mbi kapacitetet dhe vendndodhjet e mundshme të votimit në secilin mision diplomatik.

Sikur rëndom, edhe në këto zgjedhje, operacioni i votimit jashtë vendit dhe rezultatet e tij, ishin prej çështjeve më të ndjeshme dhe polarizuese. Polemikën kryesore ishin mes LVV-së dhe LDK-së, të cilat shfaqën luhatjet më drastike midis dy mënyrave të votimit jashtë vendit. Lëvizja Vetëvendosje, e cila kishte fituar bindshëm votën e mërgimtarëve nëpër ambasada (afërsisht katër në çdo pesë vota), mori vetëm rreth gjysmën e votave postare të diasporës. Konkretisht, LVV siguroi ~51.6% të totalit të votave me postë, një rezultat që e poziciononte atë ende të parën, por shumë më i ulët sesa performanca e saj prej ~80% në qendrat e votimit në misionet diplomatike. Në anën tjetër, LDK doli e dyta në votat me postë me 30.5%, që përbënte një ngritje të ndjeshme krahasuar me vetëm ~7% të votave që mori nga votimi në misionet diplomatike. Vetë zyrtarët e LDK-së e pranuan se rezultati i tyre befasisht në votat postare ishte një ndryshim i madh, por e arsyetuan atë si produkt të mobilizimit të diasporës së vet. Në një deklaratë publike, LDK theksoi se "rezultati i tyre shumë pozitiv përmes postës është punë e përkrahjes [së] aktivistëve të saj nga diaspora" duke sugjeruar se struktura dhe simpatizantët e LDK-së jashtë vendit kishin punuar intensivisht për të siguruar vota me postë.

Përveç nivelit partiak, mospërputhjet u panë edhe në votat preferenciale për kandidatët të caktuar, veçanërisht brenda listës së LDK-së. Një rast që u vu në qendër të vëmendjes ishte ai i kandidatit Hysen Çekaj (LDK), një emër relativisht i ri në politikë dhe pjestar i diasporës

vetë (djalë i veprimtarit të njohur Sali Çekaj), arriti një sukses të jashtëzakonshëm në votat e diasporës me postë, duke marrë rreth 12 mijë vota vetëm nga zarfat jashtë vendit. Gjithashtu, duke krahasuar votat e Çekajt jashtë vendit me ato brenda Kosovës, vërehet se rreth gjysma e totalit të votave të tij vinin nga diaspora.

Lëvizja Vetëvendosje, si fituesja e zgjedhjeve por e goditur nga ulja e përqindjes së saj tek votat me postë, ngriti shqetësimin publik se këto mospërputhje ishin rezultat i manipulimit të organizuar. Më 8 mars 2025 – rreth një muaj pas zgjedhjeve – LVV depozitoi ankesa dhe deklaroi publikisht se “ka pasur manipulime dhe keqpërdorime të shumta nga anëtarët e LDK-së, ku votimet [me postë] kanë ndodhur në mënyrë të manipuluar masivisht, me të njëjtin kimik dhe nga të njëjtat duar”.² Nga ana tjetër, Lidhja Demokratike e Kosovës i mohoi kategorikisht këto akuza dhe kaloi në kundërsulm politik. Zyrtarët e LDK-së argumentuan se LVV po mundohej të zhvlerësonte votën e diasporës vetëm sepse rezultati nuk i pëlqeu.³

Përtej retorikës publike, LVV i çoi pretendimet e saj për manipulim në instancat ligjore përgjegjëse për zgjedhjet. Më 15 mars 2025, sapo KQZ shpalli rezultatet përfundimtare, Lëvizja Vetëvendosje dorëzoi tri ankesa pranë Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashpresa (PZAP). Paralelisht me ankesat zgjedhore, LVV depozitoi edhe një kallëzim penal lidhur me pretendimet e manipulimit. Prokuroria Themelore në Prishtinë konfirmoi se ka nisur hetimet mbi çështjen e votave me postë, pasi Vetëvendosje paraqiti prova të dyshuara për keqpërdorime. Më 26 mars, Prokuroria njoftoi se i ka dhënë autorizim Policisë së Kosovës për të hetuar pretendimet dhe për të grumbulluar fakte lidhur me votat e diasporës: jo tregon se, pavarësisht se procesi zgjedhor u mbyll zyrtarisht, aspekti penal i akuzave për manipulim ende po shqyrtohet. Gjithsesi, në mungesë të provave të reja apo ndonjë vendimi gjyqësor të mëvonshëm, rezultati i zgjedhjeve mbeti ai që u shpall

fillimisht – me të gjitha votat e diasporës të numëruara dhe llogaritura në rezultatin final.

Ngërçi me votat e diasporës pati disa efekte të rëndësishme në zhvillimet postelektorale dhe në perceptimin e procesit demokratik. Për shkak të ankesave të LVV-së, KQZ-ja u detyrua të shtyjë certifikimin final të zgjedhjeve për më shumë se një muaj pas 9 shkurtit. Derisa PZAP dhe Gjykata Supreme të jepnin vendimet e tyre, rezultati mbeti pezull. Kjo shtyrje, ndonëse në përputhje me afatet ligjore, krijoi pasiguri politike të përkohshme dhe zgjati negociimin për formimin e institucioneve të reja. Ngjarja e votave të diasporës acaroi më tej marrëdhëniet mes LVV-së dhe LDK-së, dy subjekte që edhe para zgjedhjeve kishin raporte të tensionuara. Akuzat e ndërsjella për “vjedhje votash” janë ndër më seriozet që mund të shkëmbejnë partitë në një demokraci, dhe kjo la gjurmë në skenën politike.

Pa dyshim, incidenti ndikoi tek perceptimi publik i integritetit të zgjedhjeve. Një proces votimi që përmban dy rezultate kaq kontradiktore brenda të njëjtës kategori votuesish vë në provë besimin e qytetarëve. Në përmbyllje, zgjedhjet e 9 shkurtit 2025 në Kosovë u certifikuan si të rregullta dhe reflektuan vullnetin e votuesve, por çështja e votave jashtë vendit la një shije të hidhur në aspektin e integritetit. Raportet ndërkombëtare vlerësuan pozitivisht zgjedhjet në tërësi, por vunë re debatet mbi votat e diasporës si një element që duhet analizuar e adresuar në të ardhmen për të siguruar standarde më të larta.

2 “LVV dorëzon ankesa në PZAP, kërkon anulimin e mbi 18 mijë votave me postë të LDK-së dhe rivotim me postë” në: <https://telegrafi.com/lvv-dorezon-ankesa-ne-pzap-kerkon-anulimin-e-18-mije-votave-poste-te-ldk-se-dhe-rivotim/#:~:text=manipulime%20dhe%20keqp%C3%ABrdorime%20t%C3%AB%20shumta,t%C3%AB%20nj%C3%ABitat%20duar%2C%E2%80%9D%20deklaroi%20Sallahu>

3 “Mori 12 mijë vota nga diaspora, Abdixhiku i del në mbrojtje djalit të heroit Sali Çekaj” në: <https://telegrafi.com/mori-12-mije-vota-nga-diaspora-abdixhiku-del-ne-mbrojtje-djalit-te-deshmorit-hysen-cekaj/#:~:text=Pik%C3%ABrisht%20p%C3%ABr%20k%C3%ABt%C3%AB%20ka%20reaguar,me%20mend%2C%20nga%20vet%20m%C3%ABrgata%E2%80%9D>

5. FUSHATA ZGJEDHORE

Për zgjedhjet e rregullta të 9 shkurtit 2025, në bazë të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, KQZ-ja përcaktoi afatin kohor prej 30 ditësh për organizimin e fushatës zgjedhore, e cila formalisht filloi më 11 janar dhe u përmbyll më 8 shkurt 2025. Ashtu si edhe në zgjedhjet paraprake, fushatës zyrtare zgjedhore i parapriu një parafushatë intensive, e cila u zhvillua sidomos nëpër rrjetet sociale dhe mediat tradicionale.

Parafushata

Mungesa e rregullimit ligjor për parafushatën zgjedhore krijoi një hapësirë të pakufizuar për aktivitetet e hershme elektorale të partive politike në Kosovë. Ky vakum u ka mundësuar subjekteve politike një fleksibilitet të madh në përcaktimin e strategjive dhe kanaleve të komunikimit me votuesit, duke e bërë praktikisht të pamundur dallimin midis aktivitetit politik të zakonshëm dhe atij zgjedhor. Si pasojë, partitë kanë ndërtuar taktika të ndryshme për të përfituar nga kjo situatë, qoftë përmes aktiviteteve në terren, takimeve me strukturat e tyre apo fushatave digjitale.

Një nga prirjet më të spikatura gjatë kësaj periudhe ka qenë dominimi i eksponentëve politikë në debatet televizive, sidomos nga spektri opozitar, të cilët kanë përdorur hapësirat mediatike për të përforcuar narrativat e tyre dhe për të sfiduar qeverinë në detyrë. Kjo ka krijuar një dinamikë të re në komunikimin elektorale, duke ofruar një platformë për polarizim të mëtejshëm politik.

Sa i përket strategjive të ndjekura nga partitë, Lëvizja Vetëvendosje e ka orientuar parafushatën e saj kryesisht jashtë Kosovës, duke u mbështetur te diaspora si një burim i rëndësishëm mbështetjeje elektorale. Përmes takimeve të shpeshta me mërgatën në disa shtete evropiane, partia në pushtet ka synuar të ruajë dhe forcojë bazën e saj elektorale, duke shmangur organizimin e takimeve të mëdha publike brenda vendit në këtë fazë të hershme. Kjo qasje tregon një strategji të menduar

për të ruajtur momentumin politik dhe për të shmangur ekspozimin e drejtpërdrejtë ndaj kritikave në terren.

Në anën tjetër, partitë opozitare kanë zhvilluar qasje të ndryshme për të mobilizuar votuesit dhe për të ndërtuar diskursin e tyre politik. Partia Demokratike e Kosovës (PDK) adoptoi një model të hapur konsultativ për hartimin e programit të saj politik, duke organizuar punëtori në të gjithë vendin me qëllim përfshirjen e publikut në procesin e formulimit të platformës zgjedhore. Kurse, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), përdori një strategji më tradicionale të angazhimit qytetar përmes takimeve të drejtpërdrejta dhe fushatës derë më derë, duke u përpjekur të krijojë lidhje më të afërta me elektoratin. Një model i ngjashëm u ndoq edhe nga koalicioni AAK-NISMA, me fokus të veçantë në përforcimin e mesazhit politik për një qeverisje më gjithëpërfshirëse dhe pragmatike.

Ndërkohë, edhe pse komunikimi politik gjatë kësaj periudhe ishte përgjithësisht i moderuar, janë vërejtur momente të polarizimit të thellë mes pozitës dhe opozitës. Retorika e ashpër ka qenë e pranishme, veçanërisht në rastet kur partitë opozitare kanë shfrytëzuar këtë fazë për të denoncuar dështimet e qeverisë, duke theksuar sfidat e ekzekutivit në raport me aleatët ndërkombëtarë, krizën institucionale dhe mangësitë në sektorët kyç të qeverisjes. Nga ana tjetër, Vetëvendosje ka ndjekur një qasje të qëndrueshme, duke u mbështetur te narrativa e saj për "pastrimin" e skenës politike nga korrupsioni dhe për nevojën e vazhdimin të reformave. Ky përplasje mes dy vizioneve të kundërta politike ka krijuar një ndarje të thelluar në diskursin publik, duke e bërë më të vështirë zhvillimin e një debati të bazuar në propozime të argumentuara dhe të matshme.

Një element tjetër i rëndësishëm i kësaj periudhe ka qenë ndërhyrja e qeverisë përmes masave financiare me ndikim social, të cilat kanë ngritur shqetësime mbi mundësinë e përdorimit të resurseve publike për qëllime elektorale. Vendime të tilla si rritja e pensioneve

për kategori të ndryshme, rritja e pagës minimale dhe shpërndarja e ndihmave financiare për segmente të ndryshme të popullsisë, ndonëse në dukje janë masa sociale të drejta, kanë ngjallur debat mbi ndikimin e tyre në zgjedhje dhe mbi motivet politike që mund të fshihen pas tyre.

Më e diskutueshmja ndër këto masa mbetet vendimi i qeverisë për të shpërndarë nga 100 euro për rreth 700,000 qytetarë si ndihmë për festat e fundvitit, një veprim që është interpretuar nga aktorët politikë si një tentativë për të ndikuar tek elektorati në prag të zgjedhjeve. Po ashtu, përfshirja e Kryeministrit Kurti në ceremoninë e ndarjes së "kartelave të punës" për të punësuarit e rinj në KEK, dhe promovimi i projekteve qeveritare gjatë kësaj periudhe, kanë krijuar perceptimin e një fushate të mbështetur mbi burimet shtetërore, një praktikë që bie në kundërshtim me standardet ndërkombëtare për barazinë e garës zgjedhore.

Në nivel lokal, janë vërejtur raste të shfrytëzimit të projekteve komunale për promovim elektorale, duke përfshirë prerjen e shiritave dhe inaugurimin e investimeve publike në prag të zgjedhjeve, një taktikë e përdorur më parë edhe nga qeverisjet e mëparshme. Këto praktika ngjallin shqetësime mbi integritetin e garës zgjedhore dhe mundësinë e ndikimit indirekt të qeverisë tek zgjedhësit përmes përfitimeve financiare dhe ekonomike.

Në përgjithësi, parafushata zgjedhore në Kosovë ka vijuar të mbetet një periudhë e pakontrolluar dhe e pandarë qartë nga fushata zyrtare, duke krijuar një terren të pabarabartë për konkurrencën mes partive politike. Përdorimi i burimeve shtetërore për përfitime elektorale, mungesa e rregullimit ligjor të kësaj periudhe dhe polarizimi i diskursit politik mbeten çështje thelbësore që duhen adresuar për të siguruar një proces zgjedhor më të drejtë dhe më transparent.

Fushata zyrtare

Fushata zgjedhore për zgjedhjet parlamentare të 9 shkurtit 2025 ishte e para me një kohëzgjatje të plotë prej 30 ditësh, duke sjellë një ritëm më të lartë të aktiviteteve dhe një angazhim të shtuar të subjekteve politike në terren dhe në hapësirat digjitale.

Gjatë kësaj periudhe, përmes mbi 40 vëzhguesve afatgjatë, Demokracia në Veprim (DnV) monitoroi një fushatë që, pavarësisht se u zhvillua në një mjedis përgjithësisht të qetë, ishte tejet e ashpër në aspektin e diskursit politik. Monitorimi i DnV-së evidentoi rreth 800 aktivitete publike të organizuara nga partitë politike në të gjitha komunat e Kosovës, përfshirë komunat me shumicë serbe, ku për herë të parë garuan gjashtë parti serbe, duke shënuar një diversifikim më të madh të konkurrencës brenda këtij komuniteti.

Ndonëse në masë të madhe është vërejtur ndryshimin i formatit të organizimeve të subjekteve politike, orientimi i tyre kryesisht në premtime elektorale është parë si vazhdimësi e trendëve të fushatave të mëparshme dhe riciklim i mesazheve paraprake. Ndonëse tubimet publike ishin forma më e preferuar e të bërit fushatë nga subjektet politike, edhe vizitat nëpër shtëpi ishin mjaft të shprehura. Ka pasur një zhvillim pozitiv nga subjektet politike në lidhje me paralajmërimin e aktiviteteve zgjedhore pranë institucioneve përkatëse, ku 96% e tubimeve janë paralajmëruar, ndërsa vetëm 4% e aktiviteteve zgjedhore nuk janë paraqitur në KKZ-të përkatëse, duke shënuar përmirësim krahasuar me zgjedhjet e mëparshme.

Një nga elementet më të theksuara të kësaj fushate ishte përshkallëzimi i retorikës dhe përdorimi i një gjuhe të ashpër nga subjektet politike dhe kandidatët e tyre. Fryma e fushatës ka pasqyruar kryesisht rivalitetet politike mes përfaqësuesve të subjekteve, në vend që të fokusohet në platforma të artikuluar politike, të cilat u publikuan vetëm disa ditë para mbylljes së fushatës, ndërsa Lëvizja Vetëvendosje nuk publikoi fare një program të shkruar. Gjatë fjalimeve të fushatës, janë hasur raste të gjuhës së urrejtjes, kryesisht mbi baza politike, e cila ka qenë e pranishme në rreth 17% të aktiviteteve zgjedhore të monitoruara. Kjo tendencë ishte e dukshme si në tubimet elektorale, ashtu edhe në hapësirat digjitale, ku u vërejt një rritje e ndjeshme e rasteve të gjuhës së urrejtjes dhe fyerjeve. Diskursi i urrejtjes qoi në një numër rekord të gjobave të shqiptuara nga PZAP-ja, me një total prej mbi 600 mijë eurosh.

Për herë të parë, PZAP-ja filloi shqiptimin e ndëshkimeve edhe për shkeljet e supozuara nga mbështetësit

e subjekteve politike, për shkak të gjuhës së përdorur nga ana e tyre, qoftë në tubime në terren apo në rrjete sociale. Gjithashtu, fenomeni i dezinformimit dhe përhapjes së mesazheve manipulative ishte i pranishëm, sidomos në rrjetet sociale dhe platformat digjitale, duke ndikuar në perceptimin e publikut mbi kandidatët dhe platformat politike.

Përtej ashpërsimit të retorikës dhe intensitetit të fushatës, disa incidente kanë shënuar këtë periudhë, duke ngritur shqetësime mbi respektimin e standardeve demokratike. Rastet kryesore të incidenteve përfshijnë hedhjen e mjeteve të forta dhe atyre piroteknike në një tubim në Skenderaj⁴, djegien e materialeve propaganduese të kandidatëve, si dhe disa incidente në komunat me shumicë serbe, të tilla si pengimi i aktiviteteve elektorale në Graçanicë, hedhja e një kokteji molotovi mbi një veturë të KQZ-së⁵ dhe disa incidente të tjera në veri të vendit. Këto raste jo vetëm që kanë rritur tensionet në terren, por gjithashtu kanë ndikuar në perceptimin mbi lirinë e grumbullimit gjatë fushatës.

Nga ana tjetër, një aspekt pozitiv i kësaj fushate ishte vëmendja më e madhe e subjekteve politike ndaj çështjeve programore, duke reflektuar një përpjekje më të strukturuar për të adresuar temat me interes për qytetarët. Përkundër rasteve të gjuhës së urrejtjes dhe diskursit polarizues, debatet politike në tërësi shfaqën një nivel më të lartë të diskutimit mbi çështje konkrete si arsimi, ekonomia, mirëqenia sociale, siguria dhe mbrojtja. Një tipar dallues i kësaj fushate ishte diferencimi i qartë i prioritetëve mes partisë në pushtet dhe partive opozitare. Derisa partia në pushtet e orientoi narrativën e saj kryesisht rreth çështjeve të sovranitetit dhe integritetit territorial, me fokus të veçantë në veriun e vendit, partitë opozitare u përqendruan më shumë në problematikat ekonomike dhe arsimin, duke ofruar alternativa për zhvillimin dhe rimëkëmbjen e vendit. Ky diversitet në prioritetet politike pasqyroi qasjet e ndryshme të subjekteve në raport me sfidat e vendit, megjithatë, shpeshherë mungoi një analizë më e thelluar dhe konkrete mbi zbatueshmërinë e propozimeve të tyre.

Gjatë fushatës zgjedhore, peizazhi mediatik ishte i polarizuar, duke u karakterizuar nga dy zhvillime kryesore: partia në pushtet mbajti një qasje vazhdimisht konfrontuese ndaj gazetarëve, ndërsa disa media u perceptuan si të njëanshme në mbulimin dhe raportimet e tyre. Kryeministri dhe zyrtarët e partisë në pushtet përdorën një retorikë sulmuese ndaj mediave, duke i akuzuar për manipulim dhe ndikim negativ në opinionin publik. Në disa raste, ekipe të gazetarëve u penguan të raportonin nga terreni, ndërsa bojkoti i disa medimeve nga Lëvizja Vetëvendosje kufizoi ndjeshëm transparencën dhe krijoi pabarazi në aksesin e qytetarëve në informacion të balancuar mbi ofertat elektorale, duke ndikuar në cilësinë e debatit publik. Mediat kanë qenë të pranishme në 39% të aktiviteteve zgjedhore të monitoruara.

Ashtu si në zgjedhjet paraprake, mungesa e kulturës së njëmendtë të konkurrencës politike rezultoi me mungesë të debateve dhe përballjeve mes kandidatëve të subjekteve politike, që mund të ketë limituar votuesit në përcaktimin e votës së tyre bazuar në orientime të qarta programore. Me gjithë këto, është vërejtur një motivim dhe entuziazëm i shtuar qytetar për të marrë pjesë në aktivitete zgjedhore.

Fushata e këtij viti ka sjellë gjithashtu një mobilizim të madh në rrjetet sociale, me një rritje të konsiderueshme të numrit të postimeve të sponsorizuara dhe shpenzimeve për promovim digjital nga ana e partive dhe kandidatëve. Pavarësisht rritjes së intensitetit të fushatës online, transparenca mbi financimin e këtyre aktiviteteve mbetet çështje e hapur, me monitorimin që ka evidencuar vështirësi në identifikimin e burimeve të financimit dhe kontrollin e shpenzimeve nga organet përkatëse.

Përdorimi i resurseve publike, financiare apo njerëzore, sidomos nga subjektet politike në pushtet – si në nivelin qendror ashtu edhe në atë lokal – ka vijuar që si fenomen të shoqërojë aktivitetet e fushatës së subjekteve politike, ndonëse jo në përmasa sikur gjatë zgjedhjeve paraprake. Ky fenomen është evidentuar në 6% të aktiviteteve.

4 "Kurti kërkon votën në Drenicë mes hedhjes së mjeteve piroteknike", në <https://www.koha.net/arberi/tensione-prane-tubim-it-te-kurtit-ne-skenderaj-intervenon-policia>

5 "Vetura e një anëtareje të KQZ-së sulmohet me koktej molotovi në Ranillug, prokurori jep detaje", në <https://kallxo.com/lajm/vetura-e-nje-anetareje-te-kqz-se-sulmohet-me-koktej-molotovi-ne-ranillug-prokurori-jep-detaje/>

Një tjetër çështje me rëndësi gjatë kësaj fushate ishte përfshirja e grave dhe grupeve të marginalizuara në proces. Përgjithësisht, edhe gjatë kësaj fushate, pavarësisht retorikës së shtuar të subjekteve politike për përfaqësim të barabartë gjinor, pjesëmarrja e grave në aktivitetet e fushatës mbeti e ulët, si në aspektin e hapësirës së ofruar për gratë kandidatë, qoftë si folëse në tubime apo debate televizive. Si folëse, gratë kanë marrë pjesë në vetëm 27%, ndërsa si pjesëmarrëse vetëm në 14% të aktiviteteve të monitoruara. Për më tepër, gratë kandidatë u përballën me një numër të lartë sulmesh të drejtpërdrejta në hapësirat online, një prirje që tregon sfidat e vazhdueshme në sigurimin e një mjedisi të barabartë për të gjithë pjesëmarrësit në procesin zgjedhor.

Pavarësisht se në Kosovë jetojnë mbi 200,000 persona me aftësi të kufizuara, pjesëmarrja e tyre në aktivitete zgjedhore mbetet tejet e ulët. Në këtë fushatë zgjedhore, në asnjë rast nuk ka pasur persona me aftësi të kufizuar të cilët i janë adresuar elektoratit. Mungesa e infrastrukturës së duhur për qasje të personave me aftësi të kufizuara ka vështirësuar dhe më tej pjesëmarrjen e tyre në aktivitetet zgjedhore, meqenëse në 17% të aktiviteteve nuk është garantuar qasje adekuate për këtë kategori.

Shpenzimet e subjekteve politike gjatë fushatës

Gjatë fushatës zgjedhore 30-ditore, Demokracia në Veprim (DnV) ka monitoruar dhe analizuar shpenzimet e subjekteve politike dhe kandidatëve të tyre në rrjetet sociale. Të dhënat e mbledhura tregojnë një rritje të ndjeshme të numrit të postimeve të sponsorizuara dhe të shumës totale të shpenzuar, duke reflektuar një përqendrim të theksuar të strategjive të fushatës në hapësirën digjitale.

Në total, janë identifikuar rreth 8,000 postime të sponsorizuara nga subjektet politike dhe kandidatët e tyre, me një shumë të përgjithshme të shpenzimeve që kap vlerën mbi 200,000 euro. Kjo rritje e ndjeshme e investimeve në fushata digjitale tregon se rrjetet sociale po shndërrohen në mjetin primar të komunikimit elektorale, duke zëvendësuar në një masë të madhe format tradicionale të promovimit.

Analiza e të dhënave tregon se gjatë javës së fundit të fushatës ka pasur një intensifikim masiv të sponsorizimeve, që sugjeron përpjekje të partive dhe kandidatëve për të përforcuar mesazhet e tyre elektorale në momentet e fundit të garës.

Në listën e kandidatëve me shpenzimet më të larta për sponsorizime në Facebook dhe Instagram kryeson kandidati i LDK-së për Kryeministër, Lumir Abdixhiku, me mbi 18,000 euro të shpenzuara për 153 postime të sponsorizuara. Pas tij renditet kandidati i PDK-së, Bedri Hamza, me mbi 17,000 euro, të shpërndara në rreth 300 postime. Interesante është se në vendin e tretë për shpenzime renditet një subjekt nga komuniteti rom, Opre Roma Kosova, me një total prej 16,000 euro të shpenzuara. Lëvizja Vetëvendosje, si partia në pushtet, ka sponsorizuar numrin më të madh të postimeve – rreth 900 – por me një vlerë relativisht më të ulët, 14,000 euro.

Profilat e Memli Krasniqit – me 10 mijë euro; Ramush Haradinajt – me gati 9 mijë euro; profili zyrtar i LDK-së me rreth 8 mijë euro; kandidatit të LDK-së, Krenar Xhaferi – me 5,600 euro; kandidatit të AAK-së, Egzon Kelmendi – me rreth 4 mijë euro; si dhe kandidatës së PDK-së, Aurora Berisha – me 3,400 euro; përmbyllin listën e top dhjetë shpenzuesve më të mëdhenj në rrjetet sociale për 30 ditët e kaluara.

Pavarësisht shpenzimeve të larta, transparenca mbi financimin e këtyre aktiviteteve mbetet e diskutueshme. Monitorimi i DnV ka evidentuar sfida në ndjekjen e burimeve të financimit dhe kontrollin e shpenzimeve nga institucionet përkatëse, gjë që ngritë pikëpyetje mbi mundësinë e financimeve të padeklaruar apo përdorimit të fondeve nga burime të paidentifikuara.

Në përgjithësi, fushata zgjedhore e vitit 2025 është zhvilluar pa incidente madhore që do të kishin ndikuar në ecurinë e përgjithshme të procesit, por ka ngritur shqetësime serioze mbi cilësinë e debatit politik dhe respektimin e etikës zgjedhore.

6. PËRFSHIRJA E GRAVE NË PROCES ZGJEDHOR

Përfaqësimi dhe përfshirja e grave në zgjedhjet parlamentare të 9 shkurtit 2025 vazhduan të jenë të kufizuara dhe të mbeten larg synimeve për barazi gjinore në përfaqësim politik. Pavarësisht dispozitave të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme që garantojnë një kuotë minimale prej 30% për gratë në listat e kandidatëve, shumica dërrmuese e partive politike u mjaftuan me respektimin minimal të këtij detyrimi ligjor, pa e përkthyer atë në një angazhim për barazi reale në vendimarrje.

Nga 1,280 kandidatë të certifikuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), vetëm 441 ishin gra – përkatësisht 34%, duke treguar se përfaqësimi gjinor në listat zgjedhore mbetet i pabarabartë dhe i varur nga kuota ligjore më shumë sesa nga vullneti i partive politike. Në këtë aspekt, vetëm Lëvizja Vetëvendosje (LVV) tejkaloi ndjeshëm prapësinë ligjor, duke përfshirë 37% gra në listën e saj, ndjekur nga Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dhe Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) me nga 35%, ndërsa koalicioni AAK-NISMA arriti vetëm 33%.

Ndërkohë që Gjykata Kushtetuese, në prag të zgjedhjeve, vërtetoi se neni 28 i Ligjit për Zgjedhjet është në përputhje me Kushtetutën dhe nuk cenon të drejtat zgjedhore të kandidatëve, Ligji për Barazi Gjinore, i cili kërkon përfaqësim të barabartë 50/50 në të gjitha nivelet e vendimarrjes, mbeti ende pa zbatim të plotë në praktikën zgjedhore.

Përfaqësimi i grave në institucionet zgjedhore

Nga 13,193 zyrtarë të angazhuar si anëtarë të Këshillave të Vendotimeve në zgjedhjet e 9 shkurtit 2025, vetëm 4,217 ishin gra. Në përbërjet e Komisioneve Komunale Zgjedhore (KKZ), nga gjithsej 216 zyrtarë, vetëm 51 ishin gra. Subjekti politik me përfshirjen më të lartë të grave në KKZ ishte Lëvizja Vetëvendosje (43.24%), ndjekur nga


LDK me 8 gra, GI-SPO me 7, dhe AAK e Lista Serbe me nga 6 gra secila. Në Komisionet Komunale Zgjedhore, gratë përbënin vetëm 23% të anëtarëve dhe vetëm 16% të kryetarëve.





Edhe në nivelet më të larta institucionale, përfaqësimi gjinor mbeti i pabarabartë. Vetëm dy nga 11 anëtarët e KQZ-së janë gra. Gratë përbënin rreth 28% të anëtarëve të komisioneve të vendotimeve – një përqindje ende e ulët për një sistem që synon gjithëpërfshirjen.

Rezultatet dhe përfaqësimi në Kuvend

Rezultatet e publikuara nga KQZ tregojnë se në përbërjen e re të Kuvendit të Kosovës do të jenë 45 gra deputete, prej të cilave 39 janë zgjedhur pa qenë nevoja për të aplikuar kuotën gjinore. Kjo paraqet një përmirësim të rëndësishëm krahasuar me zgjedhjet e vitit 2021, kur vetëm 32 gra ishin zgjedhur pa kuotë. Ndërkohë, përbërja e legjislaturës së mëparshme përfshinte 40 gra, dy prej të cilave ishin lidere të partive parlamentare, dhe shtatë komisione parlamentare drejtoheshin nga gra.

Ky progres është domethënës, por jo i mjaftueshëm për të arritur barazi reale në përfaqësim. Për më tepër, fakti që pjesa më e madhe e grave u zgjedhën nga radhët e LVV-së nënvizon se rritja e përfaqësimit nuk ka qenë rezultat i një përpjekjeje të barabartë mes partive, por më shumë refleks i dinamikave elektorale të një partie të vetme.

Lëvizja Vetëvendosje (LVV)	BURRA  69	GRA  41	GJITHSEJ   110	% E GRAVE  37%
Partia Demokratike e Kosovës (PDK)	BURRA  72	GRA  38	GJITHSEJ   110	% E GRAVE  35%
Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK)	BURRA  72	GRA  38	GJITHSEJ   110	% E GRAVE  35%
Kosova Demokratik Türk Partisi (KDTP)	BURRA  18	GRA  7	GJITHSEJ   25	% E GRAVE  28%
Socialdemokrataska Unija (SDU)	BURRA  25	GRA  15	GJITHSEJ   40	% E GRAVE  38%
Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës (IRDK)	BURRA  26	GRA  15	GJITHSEJ   41	% E GRAVE  37%
Koalicija Vakut	BURRA  32	GRA  16	GJITHSEJ   48	% E GRAVE  33%
Partia e Ashkalinjëve për Integrim (PAI)	BURRA  24	GRA  11	GJITHSEJ   35	% E GRAVE  31%
Nova Demokratska Stranka (NDS)	BURRA  27	GRA  19	GJITHSEJ   46	% E GRAVE  41%
Jedinstvena Goranska Partija (JGP)	BURRA  18	GRA  11	GJITHSEJ   29	% E GRAVE  38%

Za Slobodu Pravdu i Opstana (SPO)	BURRA  8	GRA  4	GJITHSEJ   12	% E GRAVE  33%
AAK - Nisma - Lista Konservatore, Forumi intelektual	BURRA  74	GRA  36	GJITHSEJ   110	% E GRAVE  33%
Fjala	BURRA  14	GRA  8	GJITHSEJ   22	% E GRAVE  36%
Partia Rome e Bashkuar e Kosovës (PREBK)	BURRA  38	GRA  18	GJITHSEJ   56	% E GRAVE  32%
Partia Liberales Egjiptiane (PLE)	BURRA  41	GRA  20	GJITHSEJ   61	% E GRAVE  33%
Srpska demokratija (SD)	BURRA  9	GRA  4	GJITHSEJ   13	% E GRAVE  31%
Yenilikçi Türk Hareket Partisi (YTHP)	BURRA  16	GRA  9	GJITHSEJ   25	% E GRAVE  36%
Kosova Adalet Türk Partisi (KATP)	BURRA  1	GRA  0	GJITHSEJ   1	% E GRAVE  0%
Koalicioni për Familje	BURRA  49	GRA  22	GJITHSEJ   71	% E GRAVE  31%
Partia Balli Kombëtar Demokrat Shqiptar (PBKDSH)	BURRA  64	GRA  31	GJITHSEJ   95	% E GRAVE  33%

Srpski narodni pokret (SNP)	BURRA 7	GRA 5	GJITHSEJ 12	% E GRAVE 42%
Partija kosovskih Srba (PKS)	BURRA 5	GRA 4	GJITHSEJ 9	% E GRAVE 44%
Koalicioni PDAK-LPB	BURRA 65	GRA 35	GJITHSEJ 100	% E GRAVE 35%
Nša Bošnjačka Koalicija	BURRA 19	GRA 9	GJITHSEJ 28	% E GRAVE 32%
Iniciative Narodna Pravda	BURRA 6	GRA 4	GJITHSEJ 10	% E GRAVE 40%
Opire Roma Kosova - ORK	BURRA 7	GRA 5	GJITHSEJ 12	% E GRAVE 42%
Kandidati te Pavarur - Fatmir Bytyqi	BURRA 1	GRA 0	GJITHSEJ 1	% E GRAVE 0%
Srpska Lista	BURRA 32	GRA 16	GJITHSEJ 48	% E GRAVE 33%

Gjithsej	BURRA 839	GRA 441	GJITHSEJ 1280	% E GRAVE 33%
-----------------	--------------	------------	------------------	------------------

Tabela 3: Përbërja gjinore e listave të certifikuara të subjekteve politike

**LVV - Lëizja
Vetëvendosje!**



BURRA



21

GRA



16

TOTALI



37

% E GRAVE



**PDK- Partija
Demokratike e
Kosovës**



BURRA



33

GRA



4

TOTALI



37

% E GRAVE



**LDK - Lidhja
Demokratike e
Kosovës**



BURRA



29

GRA



8

TOTALI



35

% E GRAVE



**AAK- Aleanca
për Ardhmërin e
Kosovës**



BURRA



29

GRA



6

TOTALI



35

% E GRAVE



LS- Lista Serbe



BURRA



15

GRA



6

TOTALI



21

% E GRAVE



IRDK



BURRA



9

GRA



2

TOTALI



11

% E GRAVE



DSB Vakut



BURRA



4

GRA



1

TOTALI



5

% E GRAVE



GI-SP0



BURRA



9

GRA



7

TOTALI



16

% E GRAVE



KDTP



BURRA



5

GRA



1

TOTALI



6

% E GRAVE



PAI



BURRA



6

GRA



0

TOTALI



6

% E GRAVE



SDU	►	BURRA  2	GRA  0	TOTALI   2	% E GRAVE  0.00%
Romni iniciativa -RI	►	BURRA  1	GRA  0	TOTALI   1	% E GRAVE  0.00%
JGP	►	BURRA  1	GRA  0	TOTALI   1	% E GRAVE  0.00%
NDS	►	BURRA  1	GRA  0	TOTALI   1	% E GRAVE  0.00%
LPRK	►	BURRA  0	GRA  0	TOTALI   0	% E GRAVE  0.00%

Tabela 4: Përbërja gjinore e Komisioneve Komunale Zgjedhore

7. VËZHIMI I ZGJEDHJEVE

Vëzhgimi zgjedhor ka një rol të pazëvendësueshëm në rritjen e transparencës dhe besueshmërisë së zgjedhjeve në Kosovë. Korniza ligjore për zgjedhjet garanton të drejtën për vëzhgim nga aktorët vendorë dhe ndërkombëtarë, përfshirë qytetarët, partitë politike, organizatat e shoqërisë civile, si dhe misionet ndërkombëtare. Ligji gjithashtu përcakton të drejtat dhe detyrimet e vëzhguesve, duke përfshirë parimin e paanshmërisë dhe neutralitetit. Megjithatë, një shqetësim i shfaqur edhe nga misioni i vëzhgimit të BE-së lidhet me periudhën e kufizuar të akreditimit të vëzhguesve – vetëm një muaj para ditës së zgjedhjeve – çka nuk përputhet me fazat më të rëndësishme të procesit zgjedhor, përfshirë publikimin dhe kontestimin e listës paraprake të votuesve.

Zgjedhjet parlamentare të 9 shkurtit 2025 u monitoruan nga një numër i konsiderueshëm vëzhguesish, duke dëshmuar interesin e lartë për integritetin e procesit zgjedhor. Në total, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) akreditoi mbi 20,000 vëzhgues të ndryshëm, përfshirë 22 organizata vendore dhe 11 ndërkombëtare.

Partitë politike përbënin pjesën dërrmuese të këtij numri, me gjithsej 18,432 vëzhgues të akredituar.⁶ Lëvizja Vetëvendosje (LVV) udhëhoqi listën me 4,356 vëzhgues, pasuar nga Partia Demokratike e Kosovës (PDK) me 4,034, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) me 3,962 dhe koalicioni AAK-NISMA me 3,571. Lista

Serbe, edhe pse me pjesëmarrje të kufizuar dhe me certifikim të vonuar, arriti të angazhojë 290 vëzhgues. Ky mobilizim masiv reflekton përpjekjen e subjekteve politike për të ruajtur integritetin e votës në secilin vendvotim dhe për të monitoruar konkurrencën në kohë reale.

Ndërkohë, misionet ndërkombëtare kontribuan në mënyrë substanciale në monitorimin e procesit. Misioni i Bashkimit Evropian për Vëzhgimin e Zgjedhjeve (EU EOM) ishte prania më e madhe ndërkombëtare, me gjithsej 163 vëzhgues afatgjatë dhe afatshkurtër të shpërndarë në të gjithë territorin. Gjithashtu, u akredituan 11 organizata ndërkombëtare, dhjetë misione diplomatike rezidente dhe gjashtë delegacione të administratave zgjedhore të huaja. Ndër institucionet më të rëndësishme që kontribuan ishin Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës (54 vëzhgues), OSBE, NDI (35 vëzhgues), si dhe ambasadat e Shteteve të Bashkuara (24), Mbretërisë së Bashkuar (30) dhe Bashkimit Evropian (19).

Roli i organizatave të shoqërisë civile

Organizatave vendore të shoqërisë civile patën një rol kyç në sigurimin e transparencës së procesit zgjedhor. Në total, KQZ akreditoi 22 organizata vendore me gjithsej 1,193 vëzhgues.⁷ Institucioni i Avokatit të Popullit ishte

6 1. Lëvizja VETËVENDOSJE! angazhoi 4,356 vëzhgues; 2. Partia Demokratike e Kosovës – 4034 vëzhgues 3. Lidhja Demokratike e Kosovës, 3,962 vëzhgues; 4. Kosova Demokratik Türk Partisi, 257 vëzhgues; 5. Socijaldemokratska Unija – SDU, 102 vëzhgues; 6. Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës – IRDK, 158 vëzhgues; 7. Srpska Lista, 290 vëzhgues; 8. AAK – Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës NISMA – Nisma Socialdemokrate, Konservatorët, Intelektualët, 3,571 vëzhgues; 9. Opre Roma Kosova, 21 vëzhgues; 10. Koalicija Vakrat, 700 vëzhgues; 11. Srpski narodni pokret, 88 vëzhgues; 12. Za Slobodu Pravdu i Opstanak, 96 vëzhgues; 13. Yenilikçi Türk Hareket Partisi, 51 vëzhgues; 14. Koalicioni për Familje, 253 vëzhgues; 15. Gradjanska Inicijativa Narodna Pravda, 26 vëzhgues; 16. PDAK-LPB, 74 vëzhgues; 17. Naša Bošnjačka Koalicija (Naša Inicijativa i Bošnjačka stranka, 28; 18. Partija kosovskih Srba, 11 vëzhgues; 19. Nova Demokratska Stranka, 260 vëzhgues; 20. Partia Liberale Egjiptiane – PLE, 36 vëzhgues; 21. Jedinstvena Goranska Partija, 58 vëzhgues.

7 1. Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), me 306 vëzhgues; 2. Lëvizja FOL, me 6 vëzhgues; 3. Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Hulumtuese (BIRN), me 48 vëzhgues; 4. Rrjeti i OJQ-ve AVONET, me 4 vëzhgues; 5. Qendra për Politika dhe Avokim (QPA), me 140 vëzhgues; 6. Democracy Plus, me 11 vëzhgues; 7. Qendra Kulturore Orfeu, me 154 vëzhgues; 8. Germin, 16 vëzhgues; 9. Demokracia për Zhvillim (D4D), me 9 vëzhgues; 10. Syri i Vizionit, me 124 vëzhgues; 11. Rinia për Zhvillim dhe Bashkëpunim, me 14 vëzhgues; 12. INTERNWES KOSOVA, me 21 vëzhgues; 13. PIPOS, me 81 vëzhgues; 14. Youth Association for Human Rights, me 2 vëzhgues; 15. Kosovo Center for International Cooperation, me 56 vëzhgues; 16. Udruženje Gradjana RESTART, me 24 vëzhgues; 17. Primo la Tolleranza, me 17 vëzhgues; 18. Centre For Social Inclusion Gracanica, me 27 vëzhgues; 19. Center for Cooperation and Networking of Organizations, me 13 vëzhgues; 20. Centar za Mir i Toleranciju Pristina, me 36 vëzhgues; 21. ADVOCACY CENTER FOR DEMOCRATIC CULTURE, me 17 vëzhgues.

gjithashtu pjesë e këtij numri , duke përfaqësuar një qasje institucionale për mbrojtjen e të drejtave të votuesve gjatë ditës së zgjedhjeve.

Rrjeti më i madh i vëzhgimit qytetar ishte koalicioni “Demokracia në Veprim” (DnV), i cili angazhoi gjithsej 730 vëzhgues në ditën e zgjedhjeve dhe shpërndau vëzhgues afatgjatë në të gjitha komunat e Kosovës për të monitoruar mjedisin parazgjedhor, fushatën, shpenzimet zgjedhore, përdorimin e burimeve publike dhe gjuhën e urrejtjes. DnV publikoi raporte të rregullta publike gjatë gjithë fushatës dhe ofroi një analizë të detajuar të integritetit të zgjedhjeve. Gjatë ditës së zgjedhjeve, rrjeti realizoi edhe një numërim paralel të votave (PVT) në një mostër prej 500 vendvotimesh, duke shtuar më tej besueshmërinë e të dhënave.

Pjesëmarrja e gjerë e vëzhguesve, si nga partitë politike, ashtu edhe nga organizatat e shoqërisë civile dhe misionet ndërkombëtare, kontribuoi në forcimin e transparencës dhe llogaridhënies së procesit zgjedhor. Megjithatë, kufizimet e vendosura nga KQZ në periudhën e akreditimit – e kufizuar vetëm në muajin e fundit – e kanë kufizuar potencialin e disa aktorëve për të ndjekur të gjithë ciklin zgjedhor në mënyrë efektive. Kjo çështje është nënvizuar si rekomandim nga misioni i BE-së për vëzhgimin e zgjedhjeve, duke propozuar harmonizimin e afateve të akreditimit me fazat e rëndësishme të procesit, përfshirë shqyrtimin publik të listës së votuesve.



Partitë politike përbënin pjesën dërrmuese të këtij numri, me gjithsej 18,432 vëzhgues të akredituar. Lëvizja Vetëvendosje (LVV) udhëhoqi listën me 4,356 vëzhgues, pasuar nga Partia Demokratike e Kosovës (PDK) me 4,034, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) me 3,962 dhe koalicioni AAK-NISMA me 3,571. Lista Serbe, edhe pse me pjesëmarrje të kufizuar dhe me certifikim të vonuar, arriti të angazhojë 290 vëzhgues. Ky mobilizim masiv reflekton përpjekjen e subjekteve politike për të ruajtur integritetin e votës në secilin vendvotim dhe për të monitoruar konkurrencën në kohë reale.

8. DITA E ZGJEDHJEVE

Demokracia në Veprim ka vëzhguar mbarëvajtjen e procesit në Ditën e Zgjedhjeve përmes 500 vëzhguesve afatshkurtër të shpërndarë në 500 vendvotime nga 2,589 sa ishin gjithsej, sipas një mostre përfaqësuese. Monitorimi dhe raportimi për ecurinë e procesit të votimit dhe numërimin e rezultateve preliminare për subjektet politike është bërë sipas metodologjisë së Numërimit Paralel të Votave (PVT).

Procesi i votimit u zhvillua në përgjithësi në një atmosferë të qetë dhe demokratike, me një pjesëmarrje relativisht të lartë të qytetarëve. Nuk u raportuan incidente serioze që do të mund të cenonin integritetin e zgjedhjeve, megjithatë, u evidentuan një sërë parregullsish kryesisht të natyrës procedurale, të cilat shpesh buroin nga mungesa e përgatitjes së komisionerëve.

Hapja e vendvotimeve u bë në kohë në shumicën e rasteve, me përjashtim të 9% të vendvotimeve, që u hapën me vonesë 15-30 minuta, për arsye të tilla si mungesa e komisionerëve (13 raste), mungesa e kabinave të votimit (6 raste), ngjyrës matrikuluese (2 raste), apo broshurës së kandidatëve (1 rast). Në 73% të vendvotimeve, ishin të përfshira gra komisionere, çka tregon vazhdimësi të përfaqësimit të pamjaftueshëm gjinor në administratën zgjedhore.

Mundësitë e votimit për personat me aftësi të kufizuara fizike kanë vazhduar të jenë të cenueshme për shkak të problemeve infrastrukturore të disa qendrave të votimit. 80% e Qendrave të Votimit kanë ofruar qasje adekuate për persona me aftësi të kufizuara fizike, derisa në 20% të tyre është raportuar se hyrjet e tyre ishin fizikisht të paqasshme. Ndonëse votimi, në shumicën dërrmuese të qendrave të votimit është organizuar në katet përdhese për të shmangur vështirësitë e votuesve me aftësi të kufizuara fizike për t'iu qasur vendvotimeve në katet e sipërme, është raportuar për disa raste kur votimi është organizuar edhe në katet e sipërme të shkollave.

Brenda perimetrit prej 100 metrave në disa Qendra të Votimit, në 3% të rasteve janë hasur posterë dhe materiale tjera të fushatës politike, në kundërshtim me rregullat zgjedhore. Në anën tjetër, prania e policisë jashtë objekteve të qendrave të votimit, konform edhe përcaktimeve ligjore, nuk ka munguar në asnjë rast.

Edhe pse procesi zgjedhor është organizuar me ndryshime substanciale, posterët informues nuk ishin vendosur në gjitha qendrat e votimit nga KQZ-ja, me 15% të qendrave ku mungonin në tërësi informatat mbi ndryshimet dhe procesin e votimit në përgjithësi.

Po ashtu, mungoi njoftimi për lejimin e dokumenteve të skaduara, vendim i marrë nga KQZ vetëm një ditë para zgjedhjeve. Në 12% të vendvotimeve u lejuan raste të izoluar votimi (1 deri në 4 raste) me dokumente të pavlefshme.

Sa i përket garantimit të fshehtësisë së votës, vëzhguesit kanë raportuar se rregullimi i vendvotimeve është bërë konform rregullave të përcaktuara nga KQZ-ja për të siguruar mbarëvajtje të procesit të votimit. Përjashtim kanë bërë 2% të vendvotimeve, në të cilat është raportuar për vendosje të gabuar të kabinave, por të cilat pas bërjes publike të kësaj të dhëne nga DnV, janë rregulluar sipas standardeve për garantim të fshehtësisë së votës. Meqë në këtë proces të votimit është aplikuar për herë të parë edhe vendosja dhe funksionalizimi i kamerave regjistruese në secilin vendvotim, nuk është raportuar për rast të vendosjes së kamerave në një mënyrë që do të mund t'a cenonte fshehtësinë e votës.

Gjithsesi fshehtësia e votës në disa raste është komprometuar nga vetë votuesit. Vëzhguesit kanë raportuar se ka pasur raste të izoluar kur më shumë se një votues ka qëndruar prapa kabinës së votimit, dhe atë në 18% të vendvotimeve. Po ashtu janë evidentuar raste të izoluar të fotografimit të votës, në 6% të vendvotimeve.

Ndryshimi i qendrave të votimit për votuesit, kryesisht për shkak të shtimit apo heqjes së qendrave dhe përpjekjeve për t'iu mundësuar votuesve të votojnë sa më afër vendbanimeve të tyre, si dhe dispozitat e reja për votimin me kusht – i lejuar në vetëm një qendër votimi për votim me kusht brenda një komune – kanë bërë që disa votues të ndihen të hutuar dhe të kenë vështirësi për të gjetur vendvotimin e saktë. Është raportuar se në 52% të vendvotimeve, votuesit kanë pasur vështirësi të gjejnë vendvotimin e tyre të saktë, ndërsa numri i rasteve të tilla brenda një vendvotimi ka arritur deri në 100. Përgjatë 12 orëve sa ka zgjatur votimi, në 52% të vendvotimeve janë evidentuar deri në 10 raste, në 19% të vendvotimeve ky numër ka qenë edhe më i lartë, deri në 50 raste, ndërsa në 3% të vendvotimeve ky numër ka arritur deri në 100. Në praktikë, platforma online e KQZ-së për gjetjen apo ndërrimin e qendrës së votimit, nuk solli efektet e pritura, kryesisht edhe për shkak të mungesës së një fushate sistematike informuese në mediat televizive dhe sidomos në platformat e rrjeteve sociale.

KQZ kishte marrë vendim për aplikimin e ngjyrës matrikuluese e cila është përdorur për herë të parë për shënjimin e gishtave votuesve. Megjithatë, gjatë ditës së votimit, është raportuar për raste të shumta kur votuesit kanë shfaqur shqetësime për kualitetin e ngjyrës matrikuluese, e cila në disa raste fshihej lehtësisht.

Me qëllim të parandalimit të keqpërdorimit të së drejtës së votimit e asistencë, KQZ përmes ndryshimeve ligjore kishte shtrënguar rregullat që lejojnë votimin me asistencë, duke e reduktuar këtë mundësi vetëm tek personat që dëshmojnë aftësinë e tyre të kufizuar për të votuar me dokumente përkatëse. Përgjatë gjithë ditës, 6% e të gjithë qytetarëve që kanë votuar, kanë bërë këtë duke qenë të asistuar nga një person tjetër. Dy të tretat e të gjithë votuesve me asistencë janë raportuar të kenë qenë gra. Për më tepër, në 35% të vendvotimeve janë hasur raste të izoluar ku edhe votues të rinj në moshë kanë kërkuar të votojnë me asistencë.

Vëzhguesit e DnV-së kanë raportuar se përgjithësisht, rastet e votimit me asistencë janë evidentuar në Librin e Votimit dhe si të tilla konsiderohen të rregullta. Por

nuk janë përjashtuar edhe rastet e mosevidentimit të votimit me asistencë dhe atë në 10% të vendvotimeve, kryesisht deri në 10 raste.

Përgjatë gjithë ditës së votimit, qytetarët me të drejtë vote kanë shfaqur interesim të lartë për të marrë pjesë në zgjedhje, i cili ka qenë më i theksuar në orët e para të pasdites. Deri në orën 12:00, të drejtën kushtetuese për të votuar e kanë shfrytëzuar rreth 14.5% votuesve (me margjinë gabimi +/-0,37) nga 1,970,944 qytetarë me të drejtë vote. Në komunat me shumicë serbe, në të njëjtin interval kohor, kjo përqindje ishte mbi 24% ose gati dyfish më e lartë sesa mesatarja e përgjithshme e daljes në nivel vendi. Deri në orën 17:00, përqindja e votuesve që kishin marrë pjesë në votim u rrit në 38,9% (me margjinë gabimi +/-0,75) ndërsa në përfundim të procesit të votimit, dalja arriti në 44.1% me margjinë gabimi (+/- 0,84). Këtu nuk janë të llogaritura dalja e votuesve që kanë votuar me kusht dhe atyre që kanë votuar nga jashtë vendit.

Në përmbyllje të një procesi të qetë të votimit, vëzhguesit e DnV-së kanë raportuar se gjatë gjithë ditës nuk ka pasur incidente serioze që kanë mundur të lëndojnë integritetin e zgjedhjeve dhe gjatë punës së tyre nuk kanë hasur në pengesa në marrjen e informatave nga kryesuesit e vendvotimeve. Është raportuar se 93% e vendvotimeve janë mbyllur në kohë dhe 7% prej tyre para apo pas orës 19:00. Nuk janë raportuar raste të moslejimit të votuesve që ishin duke pritur në radhë, për të ushtruar të drejtën e votës.

Numërimi i votave për subjektet politike është bërë sipas protokolleve zyrtare, me raste të izoluar kur komisionerët kanë tentuar të bëjnë edhe numërimin e votave të kandidatëve – me 2% të vendvotimeve ku është raportuar një trend i tillë. Nuk janë raportuar raste të kundërshtimit të rezultateve nga komisionerët.

Përmes aplikimit të metodologjisë PVT për numërim, tabulim dhe verifikim të votave, DnV në orën 22:00 përmes një konference për media ka publikuar rezultatet preliminare për subjektet kryesore politike, duke mbushur një boshllëk të madh në informimin lidhur me rezultatet e numërimit të votave nga KQZ-ja. Ky boshllëk u shkaktua nga problemet serioze dhe dësh-

timi i KQZ-së me publikimin e rezultateve preliminare, pas mbylljes së vendvotimeve.

Problemet teknike dhe vonesat e KQZ-së për t'a sqaruar situatën për qytetarët e vendit menjëherë pas shfaqjes së problemeve teknike, përveç që kanë krijuar konfuzion, kanë ulur besimin e publikut në transparencën e procesit. Kjo situatë la një impakt negativ në perceptimin për organizimin zgjedhor.

As në ditën pasuese KQZ nuk dha informacione për fillimin apo përparimin e numërimit në Qendrat Komunale Zgjedhore, duke lënë boshllëk të madh në komunikim institucional – përkundër që këto procedura po aplikoheshin për herë të parë pas ndryshimeve në Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme.


ZGJEDHJET PARLAMENTARE 2025

DALJA NË ZGJEDHJE



NUMRI I QYTETARËVE
ME TË DREJTË VOTE NË
KOSOVË ËSHTË

1,970,944



9. REZULTATET ZGJEDHORE

Komisionit Qendror të Zgjedhjeve iu deshën plot 46 ditë nga dita e zgjedhjeve, më 9 shkurt, deri në certifikimin përfundimtar të rezultateve më 27 mars 2025. Këto vonesa tejkalojnë pritshmëritë normale për një proces elektoral efikas, dhe si të tilla mund të zbehinbesimin publik në kapacitetin e institucioneve për të administruar zgjedhje të rregullta. Arsyet për këtë vonesë ishin të shumta dhe ndërlidhen me problemet teknike, problemeve serioze institucionale në menaxhimin e proceseve, mungesës së trajnimit adekuat për stafin zgjedhor, si dhe, në një masë të caktuar, edhe për shkak të tensioneve politike. Këto vonesa, të kombinuara me paqartësinë që shoqëroi fazën e tabulimit dhe publikimit të rezultateve, i dhanë procesit një karakter jo vetëm të zvarritur, por edhe të kontestueshëm.

Procesi u shoqërua me një dështim – i cili u konstatua të jetë teknik, por që nuk u ofruan prova bindëse për një gjë të tillë – të uebfaqes **të KQZ-së për publikimin e rezultateve preliminare në natën e zgjedhjeve, gjë që pamundësoi publikimin e të dhënave fillestare dhe rrjedhimisht nxiti pasiguri në publik. Në mungesë të qasjes së publikut në rezultate dhe të transparencës së duhur për disa ditë, u shfaqën edhe dyshime për manipulim të mundshëm, sidomos në ato raste ku u raportuan të dhëna të pasakta apo mospërputhje aritmetike mes formularëve dhe votave të raportuara. KQZ-ja zgjodhi të mos ofrojë publikun mbi detajet e situatës së krijuar – duke u thirrur në faktin që rasti po trajtohet nga institucionet e drejtësisë – element ky që kontribuoi edhe më tej negativisht në transparencën e procesit. Edhe tani, muaj pas përmbylljes së procesit, nuk ka një raport e as deklaram zyrtar se çfarë ngjau gjatë mbrëmjes së zgjedhjeve, si dhe kush është përgjegjës për situatën.**

Përkundër parashikimeve dhe përcaktimeve ligjore që numërimi i votave preferenciale të fillonte ditën pas zgjedhjeve – më 10 shkurt, ai u shty për shkak të mungesës së përgatitjes teknike në Qendrat Komunale të Numërimit (QKN), ku mungonin pajisjet bazike dhe kishte probleme me softuerët **përkatës. Për më tepër, edhe pas fillimit**

të procesit, platformat pëkratëse digjitale për menaxhimin e rezultateve, që supozohej të siguronin përpunim të shpejtë dhe të saktë të të dhënave, rezultuan të paqëndrueshme, me ndërprerje të shpeshta dhe raste të humbjes së informacionit, që në disa komuna sollën nevojën për përsëritje të numërimit. Mbulimi i dobët me internet dhe mungesa e stafit të trajnuar në disa rajone e ngadalësuan më tej ritmin e numërimit. Numërimi nisi më 11 shkurt në katër komuna dhe vazhdoi me përfshirje graduale të komunave të tjera deri më 16 shkurt, duke tejkaluar çdo afat funksional për shpalljen e rezultateve paraprake.

Më tej, gjatë vetë procesit të numërimit, u vunë re mospërputhje midis rezultateve **të komisionerëve në vendvotime dhe vlerësimeve të ekipeve të numërimit në QKN. Rreth 6,300 fletëvotime u rivlerësuan**, si për vlefshmëri, ashtu edhe për preferencat politike **të votuesve**. Megjithatë, transparenca në disa qendra, ku fletëvotimet u shfaqën në ekran gjatë numërimit dhe të dhënat u futën në sistem në kohë reale, ishte element pozitiv i procesit.

Në përpjekje për të rikuperuar një pjesë të besimit të humbur dhe për të ofruar qasje më të lehtë në të dhëna, më 20 shkurt KQZ lansoi një platformë të re për publikimin e rezultateve, ku u përfshinë të dhëna të detajuara nga QKN-të dhe QNR-ja për subjektet dhe kandidatët. Ky veprim u mirëprit si përpjekje për përmirësim, por erdhi pas dëmtimit të perceptimit fillestar dhe nuk e neutralizoi dot plotësisht pakënaqësinë publike.

Nga data 26 shkurt deri më 5 mars, procesi i numërimit u zhvendos kryesisht në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR), ku u trajtuan votat me kusht, ato nga jashtë vendit dhe votat e personave me nevoja të veçanta. Gjithashtu, në QNR u zhvilluan edhe proceset e rinumërimit, sipas vendimeve të KQZ-së apo PZAP-së dhe Gjykatës Supreme. Ky segment i procesit u zhvillua me prani të rregullt të vëzhguesve të subjekteve politike dhe të shoqërisë civile e mediave, dhe nuk u shoqërua me vonesa të mëdha, ndonëse tensioni rreth rezultateve

tashmë ishte i rritur për shkak të performancës së dobët teknike në fazat paraprake.

Ndërkohë, procesi vazhdoi me vendime të reja të KQZ-së dhe PZAP-it për rinumërim. Më 10 mars, KQZ vendosi rinumërimin e 50 vendvotimeve, ndërsa QNR kërkoi rinumërim në vendvotime tjera për shkak të mospërputhjeve. Pas vendimit të PZAP-it, u rinumëruan edhe 1,631 vota postare që ishin shpallur fillimisht të pavlefshme, ku mbi 1 mijë prej tyre rezultuan në fund si të vlefshme.

Rezultatet përfundimtare u shpallën më 15 mars. LVV doli fituese me 48 mandate, e pasuar nga PDK me 24, LDK me 20 dhe koalicioni AAK–NISMA me 8 ulëse. Nga 10 vendet e rezervuara për komunitetin serb, Lista Serbe fitoi 9, ndërsa një vend shkoi për GI–SPO. Për komunitetet joshumicë, u ndanë 10 vende: dy për KDTP, dhe nga një për IRDK, NDS, VAKAT, PREBK, SDU, PLE, PAI dhe JGP.

Pas shpalljes së rezultateve, subjektet politike dhe kandidatët e tyre kishin në dispozicion 48 orë për të paraqitur ankesa. PZAP pranoi gjashtë të tilla, tre prej të cilave nga një kandidat i PDK-së, dy nga LVV dhe një nga koalicioni PDAK–LpB. LVV veçanërisht kërkoi anulimin e 18,933 votave postare për LDK-në dhe rinumërim në disa vendvotime në Skenderaj për shkak të dyshimeve për rezultatet e larta të bartësit të listës së PDK-së. Të gjitha këto kërkesa u hodhën poshtë nga PZAP. Përkundër ankesave tjera edhe në Gjykatën Supreme, edhe kjo e fundit i rrëzoi të gjitha ankesat e parashtuara, respektivisht më 24 dhe 26 mars.

Në ndërkohë, më 26 mars, Prokuroria Themelore në Prishtinë autorizoi Policinë e Kosovës të fillojë hetime për procesin e votimit nga jashtë vendit, pa dhënë detaje të mëtejshme. LVV vazhdoi të kontestonte certifikimin e rezultateve për shkak të këtyre shqetësimeve, duke paralajmëruar dhe parashtruar ankesë edhe në Gjykatën Kushtetuese.

Më 27 mars, KQZ certifikoi rezultatet përfundimtare me nëntë vota për dhe dy kundër. Të dy anëtarët e propozuar nga LVV votuan kundër. Në fund, tre deputetë të zgjedhur – dy nga LDK dhe një nga PDK – refuzuan të marrin mandatin e deputetit dhe zgjodhën të vazhdojnë angazhimin si kryetarë komunash.



Gjatë vetë procesit të numërimit, u vunë re mospërputhje midis rezultateve të komisionerëve në vendvotime dhe vlerësimeve të ekipeve të numërimit në QKN. Rreth 6,300 fletëvotime u rivlerësuan, si për vlefshmëri, ashtu edhe për preferencat politike të votuesve. Megjithatë, transparenca në disa qendra, ku fletëvotimet u shfaqën në ekran gjatë numërimit dhe të dhënat u futën në sistem në kohë reale, ishte element pozitiv i procesit.

1. DREJTËSIA ZGJEDHORE

Ligji parasheh rregulla të qarta, udhëzime dhe afate të arsyeshme për parashtrimin e ankesave nga palët e interesuara lidhur me përfshirjen ose përjashtimin nga lista preliminare e votuesve, kundër certifikimit të partive dhe kandidatëve, në faza të ndryshme të votimit dhe numërimit, si dhe ndaj rezultateve përfundimtare të shpallura nga KQZ. Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) përbën instancën kryesore për trajtimin e kontesteve zgjedhore, përfshirë edhe ankesat ndaj vendimeve të KQZ-së të parashikuara në mënyrë specifike në LZG. Vendimet e PZAP-it janë të apeluarshme në Gjykatën Supreme vetëm nëse ndëshkimi përfshin një gjobë mbi 5,000 euro ose nëse ndikon në të drejtat themelore. PZAP është organ i përhershëm, i pavarur, i përbërë nga 11 anëtarë të emëruar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, dhe aktualisht funksionon me 10 gjyqtarë sipas Rregullores për Parashtrimin dhe Vendimmarrjen për Ankesat, e rishikuar në vitin 2024.

Përgjithësisht, puna e institucioneve përgjegjëse për trajtimin e kontesteve zgjedhore është vlerësuar si transparente dhe profesionale, sidomos nga ana e PZAP-it, e cila ka publikuar në mënyrë të rregullt të gjitha vendimet e marra. Gjatë zgjedhjeve parlamentare të 9 shkurtit 2025, drejtësia zgjedhore në Kosovë u përball me një numër të konsiderueshëm ankesash, veçanërisht të adresuara në PZAP. Ky institucion, përkundër sfidave me kapacitete, arriti të përmbushë standardet e nevojshme në aspektin e profesionalizmit dhe transparencës.

Fushata zgjedhore, që filloi më 11 janar dhe përfundoi më 9 shkurt në orën 07:00, u shoqërua me tubime të shumta elektorale, ku shpesh u përdor gjuhë nxitëse dhe urrejtëse. U evidentuan gjithashtu shkelje të tjera të rënda si përdorimi i burimeve publike për qëllime

zgjedhore, përfshirja e fëmijëve në fushatë, pengimi i gazetarëve dhe vendosja e materialeve në hapësira të ndaluara. Deri më 8 shkurt, PZAP kishte pranuar mbi 400 ankesa lidhur me këto shkelje të ligjit dhe rregulloreve të KQZ-së. Në total, gjatë gjithë procesit zgjedhor, PZAP ka trajtuar mbi 600 raste.

Gjatë periudhës parazgjedhore, janë paraqitur ankesa ndaj vendimeve të KQZ-së lidhur me vendosjen e qendrave të votimit jashtë vendit (nga LVV, të cilat u refuzuan). Ka pasur edhe një ankesë nga Lista Serbe kundër njoftimit të KQZ për moscertifikim, e cila u aprovua nga PZAP. Vendimi për certifikimin e Listës Serbe u kontestua nga LVV për mospërputhje me procedurat e vendimmarrjes së KQZ-së, por Gjykata Supreme e refuzoi ankesën për mungesë legjitimiteti aktiv. Katër ankesa lidhur me mungesën e shpërndarjes së fondeve publike nga KQZ u refuzuan për mungesë kompetence. PZAP gjithashtu trajtoi ankesa të partive të komuniteteve joshumicë për përbërjen e stafit zgjedhor dhe udhëzoi KQZ-në për të rishikuar formulën e përfaqësimit në përputhje me ligjin. Një ankesë e KDTP për dizajnin e fletëvotimit u refuzua si jashtë afatit.

PZAP ka shqiptuar mbi 612 mijë euro gjoba ndaj partive për shkelje të Kodit të Etikës. LVV u gjobit me 210,500€, PDK me 144,500€, LDK me 136,600€, AAK-NISMA me 37,300€, Koalicioni për Familjen me 18,500€, Lista Serbe me 26,500€, SRB Demokratija me 12,000€, Partia Kosovksi SRBA me 7,200€, Za Slobodno Pravnu i Opstanak me 3,500€, PLE me 3,000€, Nova Stranka me 4,000€, IRDK me 3,500€, VAKAT me 1,500€, PAI me 1,000€, dhe OPRA-ROMA me 1,000€.⁸ Vlen të theksohet se gati gjysma e shumës së gjobave janë shqiptuar vetëm për përdorim të gjuhës së urrejtjes (rreth 300,000€).

⁸ Të dhënat për këto gjoba janë mbledhur sipas kërkesës për qasje në informatë zyrtare dhe përgjigjes së PZAP-së, të pranuar më 19 mars 2025. Të dhënat mbi gjobat janë përfshirë bazuar edhe në vendimet e Gjykatës Supreme ku disa prej tyre janë ndryshuar pas ankesave të palëve.

Edhe pse në disa raste, PZAP-ja ka marrë parasysh masat e menjëhershme korrigjuese të palëve dhe ka ulur gjrobat, disa nga vendimet dënuese nuk kanë qenë plotësisht uniforme. Për shembull, për shkelje të ngjashme si përdorimi i gjuhës nxitëse në rastet A.nr.27/25 dhe A.nr.253/25 janë shqiptuar gjoba të ndryshme ndaj subjektit të njëjtë – përkatësisht 12,000€ dhe 5,500€. Kjo mungesë e uniformitetit është vërejtur edhe në shkelje për përdorimin e resurseve publike dhe vendosjen e posterëve. Konkretisht, në rastet e vendosjes së materialit zgjedhor ndaj një subjekti politik (PDK) pati gjoba të ndryshme. Kështu, në rastin, A.nr.48/25 u shqiptua gjobë 4,000€, ndërsa në rastin A.49/25 u shqiptua gjobë prej 5,500€ dhe në rastin A.nr.50/25 u shqiptua gjobë prej 4,000€. E njëjta dukuri ndodhi edhe në rastet nr A.nr.51/25 ku u shqiptua gjobë prej 5,500€, kurse në rastin A.56/25 u shqiptua gjobë prej 3,500€. Kurse në rastet e ngjashme për përdorim të resurseve publike, është vërejtur që ndaj një subjekti politik për shkeljet e ngjashme iu shqiptuan tri vendime të ndryshme.

Një numër i madh vendimesh u apeluar në Gjykatën Supreme, e cila në disa raste i ndryshoi ato për vërtetim jo të duhur të gjendjes faktike dhe aplikim të gabuar të së drejtës materiale. Megjithatë, edhe Gjykata Supreme nuk mbajti gjithmonë një standard të njëtrajtshëm, pasi në raste të ngjashme, vendimet e PZAP-it u vërtetuan, ndërsa në të tjera u rrëzuan. Kjo tregon për nevojën për qasje më koherente në trajtimin e kontesteve për të garantuar barazi dhe drejtësi në procesin zgjedhor.

Për shembull, rastet AA.nr.31/25 dhe AA.nr.33/25 ndaj Koalicionit për Familje u ndryshuan me arsyetimin se deklaratat nuk ishin nxitëse apo kërcënuese ndaj komunitetit LGBTI, por shprehje programore. Kurse, në një vendim tjetër (AA.nr.40/25) Gjykata Supreme konstatoi se vendimi i PZAP në rastin A.nr.278/2025, pati mungesë arsyetimi dhe për këtë arsye ndryshoi vendimin e PZAP-së me të cilin LDK ishte dënuar me 5,500 euro. Sipas Gjykatës Supreme, në këtë rast, PZAP-ja nuk kishte arritur të konstatojë drejtë dhe saktë gjendjen faktike dhe nuk e ka zbatuar drejtë të drejtën materiale.⁹



PZAP ka shqiptuar mbi 612 mijë euro gjoba ndaj partive për shkelje të Kodit të Etikës. LVV u gjobit me 210,500€, PDK me 144,500€, LDK me 136,600€, AAK-NISMA me 37,300€, Koalicioni për Familjen me 18,500€, Lista Serbe me 26,500€, SRB Demokratija me 12,000€, Partia Kosovksi SRBA me 7,200€, Za Slobodno Pravnu i Opstanak me 3,500€, PLE me 3,000€, Nova Stranka me 4,000€, IRDK me 3,500€, VAKAT me 1,500€, PAI me 1,000€, dhe OPRA-ROMA me 1,000€. Vlen të theksohet se gati gjysma e shumës së gjobave janë shqiptuar vetëm për përdorim të gjuhës së urrejtjes (rreth 300,000€).

⁹ Për më tepër shih, Gjykata Supreme e Kosovës, vendim nr. AA.nr.40/2025 datë 7 shkurt 2025. I qasshëm në linkun: https://supreme.gjygesori-rks.org/wp-content/uploads/verdicts/SUP_AA%20_40_2025_SQ.pdf.

Kodi Penal përfshin vepra penale të ndërlidhura me zgjedhjet dhe parasheh dënime me burg ose gjoba. Shtatë raste – katër gjatë fushatës dhe tre në ditën e zgjedhjeve – janë dërguar në Prokurorinë Publike dhe janë ende nën hetim. Në një rast në QNR Gjakovë, u gjetën

fletëvotime të përdorura për trajnim brenda kutisë së votimit dhe kishte mospërputhje midis numrit të nënshkrimeve dhe votave të hedhura. PZAP nuk konstatoi ndonjë rast që të përmbante elemente të veprës penale dhe nuk referoi ndonjë rast në Prokurori.

Subjekti Politik	Gjobat (€)
Lëvizja Vetëvendosje (LVV)	210,500
Partia Demokratike e Kosovës (PDK)	144,500
Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK)	136,600
Koalicioni AAK-NISMA	37,800
Koalicioni për Familjen	18,500
Lista Serbe	26,500
SRB Demokratija	12,000
Partia Kosovksi SRBA	7,200
Za Slobodno Pravnu i Opstanak – Nenad Rashiq	3,500
Partia Liberale Egjiptiane (PLE)	3,000
Nova Stranka	4,000
Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës (IRDK)	3,500
Koalicioni VAKAT	1,500
Partia e Ashkalinjëve për Integrim	1,000
Partia OPRA-ROMA	1,000

Tabela 5: Gjobat e shqiptuara ndaj subjekteve politike nga PZAP

REKOMANDIMET

Duke u bazuar në të gjeturat dhe vlerësimet e dhëna në kuadër të këtij raporti, por edhe zhvillimeve të përgjithshme lidhur me procesin zgjedhor, Demokracia në Veprim ofron një sërë rekomandimesh të cilat synojnë përmirësimin e aspekteve teknike të zgjedhjeve, por edhe sistemin zgjedhor në përgjithësi.

Këto rekomandime, kanë për qëllim iniciimin e një **reformë zgjedhore përmbajtësore**, e cila duhet të përkthehet në ndryshime të kuadrit ligjor për zgjedhje, që adresojnë natyrën teknike të organizimit dhe administrimit të zgjedhjeve, por edhe elemente tjera politike të sistemit zgjedhor. DnV-ja vlerëson që reforma zgjedhore duhet të jetë një nga prioritetet kyçe të spektrit politik duke u bazuar në parimet e gjithëpërfshirjes dhe transparencës.

Rekomandimet e mëposhtme, duhet të adresohen nga akterë të ndryshëm, duke filluar nga ligjvënësit, trupat përgjegjëse për organizimin dhe administrimin e zgjedhjeve, subjektet politike dhe kandidatët e tyre, institucionet përkatëse të sigurisë dhe drejtësisë, shoqëria civile, si dhe institucionet tjera në fushëveprimin e të cilave bie përgjegjësia për ndonjë prej operacioneve zgjedhore.

I. Reforma e sistemit zgjedhor

Demokracia në Veprim konsideron se është e domosdoshme që, përveç aspekteve teknike të përmirësimit të organizimit dhe administrimit zgjedhor, reforma zgjedhore të përfshijë edhe çështje përmbajtësore, që janë në thelb politike, e të cilat kërkojnë ndryshime kushtetuese dhe ligjore. Ndër elementet e sistemit zgjedhor, të cilat janë duke prodhuar probleme sidomos në përfaqësimin e drejtë qytetar, por dhe funksionalitetin institucional të Kosovës, që DnV vlerëson se duhet të jenë medoemos subjekt i reformës zgjedhore, janë:

1. **Votimi preferencial** deri në dhjetë kandidatë, duhet të reduktohet ndjeshëm;
2. **Pragu zgjedhor**, përkatësisht aplikimi i tij për subjekte të ndryshme politike si partitë politike, koalicionet dhe kandidatët e pavarur, duhet të rikategorizohet;
3. Mënyra së **zgjedhjes së Presidentit** të vendit, duhet të rishqyrtohet;
4. Të konsiderohet ndarja në **zona zgjedhore**;

II. Korniza ligjore

1. Të hartohet një kod i unifikuar zgjedhor që do të përfshinte të gjitha dispozitat rregullative mbi zgjedhjet në një dokument të vetëm. Kjo do të adresonte fragmentimin aktual në disa ligje dhe rregullore, duke rritur qartësinë ligjore dhe zbatueshmërinë e dispozitave.

Praktika e kodifikimit është e rekomanduar nga OSBE/ODIHR dhe Komisioni i Venecias për të siguruar qartësi ligjore dhe siguri juridike.

2. Të avancohen kriteret e përshtatshmërisë juridike, duke mos lejuar kandidimin e individëve që janë të dënuar për vepra penale të keqpërdorimit të detyrës zyrtare – pavarësisht llojit dhe lartësisë së dënimit të shqiptuar.
3. Të rishikohen dispozitat për përbërjen dhe mandatin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, me qëllim të garantimit të pavarësisë funksionale dhe institucionale të tij. Kjo mund të arrihet përmes ndarjes më të qartë të kompetencave mes KQZ-së dhe trupave teknike administruese të zgjedhjeve. Madje, duhet të merret në konsideratë ndryshimi i përbërjes së KQZ-së, duke synuar balancimin e vendimmarrjes me anëtarë jo-politikë.

4. **Të garantohet qartësimi i ndarjes së përgjegjësi-ve ndërmjet KQZ-së dhe institucioneve të tjera** për aspektet kyçe të administrimit zgjedhor, përmes dispozitave të detajuara në ligj ose rregullore të veçanta.
5. **Të rishikohet mënyra e vendimmarrjes brenda KQZ-së, duke përfshirë garanci për vendimmarrje të paanshme, të bazuar në ligj dhe jo në përkatësi politike.** Procedurat e certifikimit të subjekteve politike dhe ndarja e fondeve publike duhet të jenë të standardizuara dhe të depolitizuara. Duhet të eksplorohehen mundësitë që votimet mbi rekomandimet e Zyrës, si trupë profesionale, të bazohen në demokracinë negative – në atë mënyrë që për refuzimin e propozimit të nevojiten votat kundër të shumicës (apo 2/3 e anëtarëve), ose në të kundërtën rekomandimet konsiderohen të aprovuara. Në anën tjetër, **formula për ndarjen e fondeve publike për subjektet politike**, duhet të jetë e drejtë dhe jo diskriminuese, veçanërisht për subjektet jo-parlamentare dhe ato që marrin pjesë për herë të parë në zgjedhje.
6. **Të miratohet një Kod Sjelljeje për Anëtarët e KQZ-së, që sanksionon diskursin dhe gjuhën gjatë mbledhjeve të KQZ-së.** Për të ruajtur integritetin institucional dhe klimën demokratike, duhet të miratohet një kod i sjelljes për anëtarët e KQZ-së, i cili përfshin sanksione në rast të shkeljeve.
7. **Të përfshihen dispozita të veçanta që rregullojnë më në detaje përdorimin e teknologjisë në procesin zgjedhor,** përfshirë standardet e sigurisë kibernetike, transparencën e algoritmeve dhe auditimin e platformave digjitale të votimit dhe publikimit të rezultateve.

III. Administrimi i procesit zgjedhor

Për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve:

1. **KQZ-së duhet t'i kufizohet e drejta e marrjes së vendimeve dhe nxjerrjes së akteve lidhur me operacionet zgjedhore gjatë kohës kur të njëjtat janë në zhvillim e sipër,** duke garantuar parimin e sigurisë juridike dhe mosndryshimit të rregullave të lojës gjatë saj. Në këtë drejtim, kufizimet duhet të vlejné për secilën fazë dhe operacion zgjedhor, të tilla si fushata zgjedhore, votimi jashtë vendit, certifikimi i kandidatëve, dita e zgjedhjeve, numërimi dhe të tjera.
2. **Të rishikohet struktura organizative dhe funksionale e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.** Kjo përfshin ndarjen e qartë të rolit dhe kompetencave mes Sekretariatit dhe KQZ-së si trupë kolegjiale, funksionet e Drejtorit të Sekretariatit, si dhe definimin e kompetencave të secilës njësi të brendshme. Kjo do të sigurojë ndarje të qartë të përgjegjësi-ve brenda institucionit, efikasitet operacional dhe rritje të llogaridhënies.
3. **Të përfshihet detyrimi për raportim paszgjedhor nga KQZ-ja, përmes një raporti publik që përmblendh të gjitha fazat e procesit zgjedhor,** përfshirë vlerësimet për veten dhe rekomandimet për përmirësim, në përputhje me parimin e reflektimit institucional dhe përmirësimit të vazhdueshëm.
4. KQZ duhet të orientohet drejt **dixhitalizimit të procesit të numërimit të votave,** duke evituar gabimet njerëzore dhe manipulimet.
5. **Të zhvillohet dhe miratohet një Plan Kombëtar i Edukimit Zgjedhor të qytetarëve,** i cili do të zbatohet vazhdimisht dhe jo vetëm gjatë fushatës. Plani duhet të jetë gjithëpërfshirës, me materiale të standardizuara dhe të përshtatura për grupe të ndryshme të synuara, dhe të zbatohet në bashkëpunim me OShC-të dhe institucionet arsimore.
6. **Të rishikohet përdorimi i ngjyrës matrikuluese dhe kabinave të votimit, me qëllim garantimin**

e plotë të fshehtësisë së votës. Çdo mekanizëm identifikimi i votuesit duhet të jetë i certifikuar dhe në përputhje me të drejtat për mbrojtjen e të dhënave personale dhe fshehtësinë e votës. Përdorimi i lapsit matikulues duhet të rishqyrtohet dhe të kalohet drejt identifikimit elektronik të votuesve. Kabinat e votimit duhet të jenë të vendosura në mënyrë që sigurojnë privatësinë e plotë të votuesit dhe të përjashtojnë çdo mundësi vëzhgimi të padëshiruar.

7. Të zhvillohen **trajnime dhe testime më rigoroze për anëtarët e KVV-ve**, para se të njëjtit të caktohen në vendvotime, në mënyrë që detyrat dhe përgjegjësitë e tyre të kryhen më me profesionalizëm. Prioritet duhet të kenë procesi i numërimit, si dhe shkeljet më të shpeshta, të tilla si abuzimi me votimin me asistencë, cenimit të fshehtësisë së votimit dhe të ngjashme. Në këtë drejtim, edhe subjektet politike duhet të nominojnë komisionerë me integritet dhe përgatitje të duhur profesionale.
8. KQZ duhet të garantojë **infrastrukturë të përshtatshme fizike**, për qasje në secilin vendvotim dhe në format e qasshme të votimit **për personat me aftësi të kufizuara**.
9. Të formalizohet **publikimi i përditshëm i progresit të numërimit nga KQZ-ja**. KQZ duhet të jetë e obliguar të raportojë për çdo 12 orë mbi progresin e numërimit dhe përpunimit të rezultateve – përfshirë statistika, pengesa dhe vlerësime të rishikuara të afateve – përmes njoftimeve publike, konferencave për media dhe kanaleve digjitale.
10. Të zhvillohet dhe miratohet një **strategji afatmesme për menaxhimin e teknologjisë zgjedhore**, e cila përfshin standarde minimale të funksionalitetit, testime të pavarura para përdorimit, auditim të sigurisë dhe plan për rikuperim në rast të dështimeve sisteme.

Për trupat tjera menaxhuese të zgjedhjeve (KKZ, KVV, QKN dhe QNR):

1. Të miratohet një akt i veçantë për **rekrutimin dhe trajnimin e trupave menaxhuese të zgjedhjeve**, duke përfshirë kualifikimet minimale, standardet për barazi gjinore dhe përfaqësim të komuniteteve, si dhe vlerësimin paszgjedhor të performancës.
2. Të përcaktohen sanksione për **anëtarët e administratës zgjedhore që nuk përmbushin detyrat ose veprojnë me neglizhencë**, si dhe të krijohet një sistem formal për monitorimin dhe vlerësimin e performancës së tyre gjatë fazave përkatëse të votimit.
3. Të rishikohet dhe standardizohet **struktura organizative e Këshillave të Vendvotimeve, duke rikthyer pozitën e komisionerit për rutinë e votimit dhe duke përcaktuar qartë detyrat e secilit anëtar**. Pozita e komisionerit për rutinë e votimit duhet të rikthehet si rol i detyrueshëm, duke garantuar kontrollin e momentit kritik të hedhjes së votës.
4. Të rishqyrtohet koncepti i zhvendosjes së numërimit në QKN, duke vlerësuar **balancën ndërmjet kostos, efektivitetit dhe integritetit të procesit**. KQZ duhet të realizojë një analizë gjithëpërfshirëse të ndikimit të këtij modeli në integritetin e votës dhe besimin publik, dhe në bazë të kësaj, të vendosë nëse duhet të zgjerohet, modifikohet apo të rikthehet pjesërisht numërimi në vendvotim me mekanizma mbikëqyrës të përforcuar.
5. Të vendoset një **standard i detyrueshëm për publikimin e të dhënave të detajuara mbi mospërputhjet, rastet e rinumërimit dhe rezultatit përfundimtar të të gjitha kutive që janë trajtuar në QNR**. Publikimi i këtyre të dhënave duhet të jetë në format të hapur dhe të shoqërohet me shpjegime për secilin rast, në mënyrë që të forcohet transparenca dhe besimi publik.

6. Të krijohen **"lista të zeza" bazuar në performancën e stafit zgjedhor**, përfshirë komisionerët e KQZ-së dhe stafin në QKN dhe QNR, që është i dyshuar për manipulime apo të cilët kanë pasur performancë jo të kënaqshme. Të njëjtëve duhet t'u ndalohej pjesëmarrja në proces zgjedhor.
7. Pas përmbylljes së secilit proces zgjedhor, **Librat e Votimeve**, që janë të vendosura në secilin vendvotim, **duhet të jenë objekt i auditimit nga KQZ-ja**, në mënyrë që të evidentohen dhe trajtohen detajisht parregullsitë që janë hasur gjatë ditës së zgjedhjeve.

Lista e Votuesve:

1. Të zhvillohet dhe miratohet një sistem i përhershëm ndërinstytucional për pastrimin periodik të listës së votuesve, përmes shkëmbimit automatik dhe të detyrueshëm të të dhënave ndërmjet KQZ-së, Agjencisë për Regjistrim Civil, Agjencisë së Statistikave, KGJK-së, dhe Departamentit të Pensioneve. Ky sistem duhet të bazohet në protokolle të dakorduara për identifikimin dhe përjashtimin e votuesve të ndjerë, personave pa zotësi juridike, dhe atyre me të dhëna të dyfishta. Verifikimi duhet të kryhet në mënyrë të përhershme, jo vetëm në prag të zgjedhjeve.
2. Të institucionalizohet një auditim i jashtëm i listës së votuesve para çdo procesi zgjedhor, me përfshirjen e organizatave të pavarura ose institucioneve statistikore që do të vlerësonin përputhshmërinë e saj me të dhënat demografike reale të vendit. Ky auditim do të siguronte transparencë publike dhe do të mundësonte identifikimin e boshllëqeve strukturore në sistemin ekzistues të regjistrimit civil.

Votimi jashtë vendit:

1. Të përmirësohet ndjeshëm organizimi logjistik dhe transparencja në procesin e dërgesës dhe kthimit të zarfeve me vota nga diaspora. KQZ-ja duhet të zhvillojë rregulla të veçanta për transpor-

timin e votave me postë nga jashtë vendit, përfshirë procedura standarde të sigurisë, dokumentimin e zinxhirit të posedimit dhe mbikëqyrjen e gjithë procesit nga komisionerë të pavarur. Përfshirja e institucioneve ekzekutive, si MPJD, në transportimin e votave duhet të kufizohet përmes protokolleve të qarta që garantojnë mos-ndërhyrjen dhe paanshmërinë institucionale.

2. Të rishikohet afati i pranimit dhe numërimit të votave me postë, në mënyrë që këto të mos shkaktojnë vonesa në shpalljen e rezultateve përfundimtare. Duhet të vendosen afate të përcaktuara qartë për mbylljen e procesit të grumbullimit të zarfeve dhe për fillimin e numërimit të tyre, duke harmonizuar praktikën me ato ndërkombëtare.
3. Të rregullohet më tej ndarja e përgjegjësisë institucionale ndërmjet KQZ-së dhe MPJD-së për vendvotimet jashtë vendit. KQZ-ja duhet të ketë autoritetin e plotë mbi aspektet organizative dhe operacionale të votimit në ambasada, ndërsa MPJD-ja të mbetet vetëm mbështetëse logjistike, siç përcaktohet me ligj dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare.
4. Të zhvillohet një platformë digjitale tërësisht funksionale për regjistrimin dhe ndjekjen e statusit të aplikimit dhe votimit për qytetarët jashtë vendit. Kjo platformë duhet të mundësojë komunikim të dyanshëm me votuesit e diasporës, t'i njoftojë ata për statusin e pranimit të aplikimit, vendvotimin e caktuar dhe të japë mundësi ankimi të drejtpërdrejtë.
5. Të zbatohet auditim i pavarur dhe sistematik i të gjithë procesit të votimit jashtë vendit pas çdo palë zgjedhjeve. Ky auditim duhet të përfshijë të dhënat e regjistrimit, procedurat postare dhe rrugën e transportit të zarfeve, si dhe të publikohet për të rritur besueshmërinë publike.

IV. Fushata zgjedhore

1. **Të rregullohet me legjislacion të qartë periudha e parafushatës zgjedhore, për të parandaluar keqpërdorimin e kësaj faze nga subjektet politike dhe për të garantuar barazi në garë.** Rregullimi duhet të përcaktojë se cilat aktivitete përbëjnë fushatë të parakohshme, kufizimet për përdorimin e resurseve publike gjatë kësaj periudhe dhe detyrimet e partive për raportim financiar edhe për parafushatën.
2. **Të ndalohet me ligj shpërndarja e përfitimeve financiare të qeverisë për qytetarët brenda një periudhe të përcaktuar para zgjedhjeve, për të garantuar ndarjen e qartë mes fushatës institucionale dhe asaj elektorale.** Kjo mund të përfshijë vendosjen e një "moratoriumi" mbi masa fiskale selektive që nga dita e shpalljes së zgjedhjeve.
3. **Të miratohen dispozita të veçanta për monitorimin dhe raportimin e fushatës digjitale,** duke e detyruar çdo subjekt politik dhe kandidat që sponsorizon përmbajtje në rrjete sociale të publikojë për çdo postim të dhënat mbi shpenzimet, burimin e fondeve dhe qëllimin e sponsorizimit. KQZ duhet të kërkojë paraprakisht nga subjektet politike që të deklarojnë të gjitha llogaritë zyrtare në rrjete sociale gjatë periudhës zgjedhore.
4. **Të forcohet transparenca dhe mbikëqyrja e financimit të fushatës,** duke detyruar subjektet politike të dorëzojnë raporte të detajuara javore gjatë periudhës së fushatës, përfshirë të gjitha shpenzimet online dhe offline, me publikim të menjëhershëm në faqet zyrtare të KQZ-së dhe partive politike.
5. **Të krijohet praktikë e organizimit të debateve publike midis kandidatëve kryesorë,** të organizuara nga mediat (sidomos transmetuesi publik), me pjesëmarrje të barabartë, për të mundësuar qytetarëve krahasim të platformave në mënyrë të informuar.

Financimi i subjekteve politike gjatë fushatës

1. Financimi i subjekteve politike, sidomos gjatë periudhës së fushatës, duhet të avancohet. **Subjektet politike duhet të hapin llogari të veçanta bankare për financimin dhe shpenzimet e tyre gjatë fushatës,** të cilat duhet të jenë transparente dhe të qasshme për publikun, në faqen elektronike të KQZ-së, ndonjë portal tjetër, ose në faqet elektronike të vetë subjektit politik apo kandidatëve.
2. **Alternativë tjetër mund të jetë operacionalizimi i plotë i një sistemi elektronik për raportimin financiar të fushatës – në baza javore – i integruar në platformën e KQZ-së, i cili do të mundësonte dorëzimin, shqyrtimin dhe publikimin e menjëhershëm të të dhënave nga subjektet politike.** Platforma duhet të jetë publike dhe e qasshme për monitorim.
3. Duhet patjetër të rregullohet çështja e **deklarimit financiar për kandidatët e subjekteve politike,** duke përfshirë të hyrat dhe shpenzimet personale për periudhën gjatë fushatës.
4. **Të ndahen fonde të veçanta publike për fushatat e kandidateve gra,** duke krijuar një skemë publike financimi, që synon fuqizimin e grave në garën politike dhe reduktimin e pabarazive strukturore financiare.
5. Subjektet politike duhet të bëjnë **transparente mënyrën e shpërndarjes së fondeve të tyre për kandidatet gra,** me qëllim që të ketë përkrahje të barabartë për të gjithë kandidatët.

V. Përfaqësimi gjinor

1. **Të miratohen ndryshime ligjore që e shndërrojnë kuotën 30% për gratë në listat zgjedhore në një objektiv progresiv me targete vjetore që çojnë drejt përfaqësimit të barabartë (50/50), në përputhje me Ligjin për Barazi Gjinore.** Ky ndryshim duhet të shoqërohet me dispozita që ndalojnë listat me përfaqësim minimal të përsëritur dhe që nxisin rotacionin gjinor në pozitat e larta në lista.
2. **Të zbatohet Ligji për Barazi Gjinore në të gjitha nivelet e administratës zgjedhore,** përfshirë Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, Komisionet Komunale Zgjedhore dhe Këshillat e Vendvotimeve. Ky zbatim duhet të përfshijë detyrimin për përfaqësim të balancuar gjinor në përbërje dhe udhëheqje, me raporte vjetore të monitorimit.

VI. Drejtësia zgjedhore

1. **Të hartohet dhe miratohet një katalog i gjuhës së urrejtjes dhe shprehjeve diskriminuese në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe kushtetuese të lirisë së shprehjes.** Ky katalog do të shërbente si referencë zyrtare për institucionet përgjegjëse, duke ofruar përkufizime të qarta për gjuhën nxitëse, shprehjet e urrejtjes dhe ato që përbëjnë diskriminim ndaj grupeve të cënueshme. Dokumenti duhet të përgatitet në bashkëpunim me institucionet e drejtësisë, përfaqësues të mediave, organizatat e shoqërisë civile dhe ekspertë të të drejtave të njeriut, dhe të miratohet si aneks ose udhëzues zbatues për PZAP-in dhe KQZ-në.
2. **Të rishikohen dhe standardizohen dispozitat mbi gjobat, duke kufizuar diskrecionin dhe duke lidhur sanksionet me kritere të matshme dhe të unifikuara.** PZAP duhet të zbatojë një sistem gradimi të gjobave për çdo lloj shkeljeje, i cili përcakton qartë kufijtë minimalë dhe maksimalë, bazuar në faktorë si përsëritja e shkeljes, ndikimi në publik, përhapja përmes mediave dhe dështimi për të ndërmarrë masa korrigjuese. Rregullorja për sanksionet duhet të jetë publike dhe e azhurnuar, për të shmangur

vendimmarrjet arbitrare dhe për të garantuar proporcionalitet.

3. **Të përforcohet kapaciteti i PZAP-it përmes rritjes së numrit të stafit dhe sigurimit të burimeve të qëndrueshme teknike dhe financiare.** Duke pasur parasysh volumin e ankesave dhe rëndësinë e trajtimit të tyre me efikasitet, duhet të shqyrtohet mundësia për zgjerim të përkohshëm të kapaciteteve të PZAP-it gjatë periudhave zgjedhore, përmes aktivizimit të trupave ndihmëse apo resurseve shtesë/rezervë.
4. **Të harmonizohen standardet e vendimmarrjes ndërmjet PZAP-it dhe Gjykatës Supreme për të siguruar qasje të njëtrajtshme dhe koherente në drejtësinë zgjedhore.** Këshilli Gjyqësor, përmes trajnimeve të përbashkëta dhe analizave krahasuese të praktikës gjyqësore, duhet të kontribuojë në ndërtimin e një jurisprudence të qëndrueshme dhe të parashikueshme, që respekton të drejtën për ankesë, por gjithashtu mbron integritetin e procesit zgjedhor.
5. **Të përmirësohet mekanizmi për referimin e rasteve penale në Prokurori nga ana e institucioneve zgjedhore.** PZAP dhe KQZ duhet të kenë një protokoll të qartë bashkëpunimi me Prokurorinë e Shtetit për raportimin e rasteve që përmbajnë elemente të veprave penale. Ky protokoll duhet të përfshijë kritere për identifikimin e dyshimeve, formatin e referimit dhe afatet për veprim institucional.

Shtojca 1:

Rezultatet e certifikuara te zgjedhjeve dhe ndarja e ulëseve sipas subjekteve politike

Subjekti politik	Numri i votave	Përqindja	Numri i ulëseve
Lëvizja VETËVENDOSJE!	396,787	42.30%	48
PARTIA DEMOKRATIKE E KOSOVËS - PDK	196,474	20.95%	24
LIDHJA DEMOKRATIKE E KOSOVËS - LDK	171,357	18.27%	20
SRPSKA LISTA	39,915	4.26%	9
AAK - ALEANCA PËR ARDHMËRINË E KOSOVËS NISMA - Nisma Socialdemokrate, Konservatorët, Intellektualët	66,256	7.06%	8
KOSOVA DEMOKRATIK TÜRK PARTİSİ	4,824	0.51%	2
INICIATIVA E RE DEMOKRATIKE E KOSOVËS - IRDK	4,688	0.50%	1
NOVA DEMOKRATSKA STRANKA	4,158	0.44%	1
Za Slobodu Pravdu i Opstanak	4,139	0.44%	1
Koalicija Vakrat	3,471	0.37%	1
PARTIA LIBERALE EGJIPTIANE-PLE	3,251	0.35%	1
SOCIJALDEMOKRATSKA UNIJA - SDU	3,042	0.32%	1
PARTIA E ASHKALINJËVE PËR INTEGRIM	2,196	0.23%	1
Jedinstvena Goranska Partija	1,734	0.18%	1

Subjekti politik	Numri i votave	Përqindja	Numri i ulëseve
PARTIA ROME E BASHKUAR E KOSOVËS	1,350	0.14%	1
Koalicioni për Familje	20,023	2.13%	0
SRPSKA DEMOKRATIJA	3,271	0.35%	0
PDAK-LPB	2,056	0.22%	0
Srpski narodni pokret	1,846	0.20%	0
Yenilikçi Türk Hareket Partisi	1,800	0.19%	0
Naša Bošnjacka Koalicija (Naša Inicijativa i Bošnjacka stranka)	1,553	0.17%	0
FJALA	899	0.10%	0
Kosova Adalet Türk Partisi	642	0.07%	0
Partia Balli Kombëtar Demokrat Shqiptar	621	0.07%	0
GRADJANSKA INICIJATIVA NARODNA PRAVDA	620	0.07%	0
Partija kosovskih Srba	462	0.05%	0
Opre Roma Kosova	384	0.04%	0
Fatmir Bytyqi	191	0.02%	0

Përkrahur nga:



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC



WFD